



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada- Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja- Ministry of Economic Development

Raporti i Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2016



Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike

Tetor 2017

Përmbajtja

Lista e Tabelave	3
Lista e Grafikonëve.....	4
Lista e Figurave	4
Lista e Shkurtesave.....	5
Shqyrtime Hyrëse	7
Politikat e Pronësisë mbi Ndërmarrjet Publike	8
Zhvillimi i Qeverisjes Korporative.....	9
Kuadri Ligjor.....	11
Objektivat e Korporatës dhe Aktivitetet e Biznesit.....	11
Struktura e Kapitalit.....	12
Opinionet e Auditorëve të Jashtëm.....	13
Performanca e Ndërmarrjeve	14
Performanca e NP-ve sipas Sektorëve	16
Sektori i Energjisë.....	16
Sektori i Telekomunikimit.....	16
Sektori i Ujit	17
Punësimi në Ndërmarrje Publike	19
Raportet Individuale të Performancës	20
Posta e Kosovës ShA.	20
Telekomi i Kosovës ShA.	25
Korporata Energjetike e Kosovës ShA.....	29
Hekurudhat e Kosovës – “TrainKos” ShA.	32
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “InfraKos” ShA.....	35
Aeroporti i Gjakovës ShA.	38
Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” ShA.....	40
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë ShA.....	44
Kompania Rajonale e Ujësullësit “Prishtina” ShA.	48
Kompania Rajonale e Ujësullësit “Mitrovica” ShA.	52
Kompania Rajonale e Ujësullësit “Hidromorava” ShA.....	56
Kompania Rajonale e Ujësullësit “Hidrodrini” ShA.....	61
Kompania Rajonale e Ujësullësit “Hidroregjioni Jugor” ShA.....	64
Kompania Rajonale e Ujësullësit “Radoniqi” ShA.	67
Kompania Rajonale e Ujitjes “Drini i Bardhë” ShA.	70
Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniqi – Dukagjin” ShA.....	73
Konkludime dhe Rekomandime.....	77
Dokumentet Burimore.....	79

Lista e Tabelave

Tabela 1: Krahasimi i Opinioneve të Auditorëve të Jashtëm 2015-2016.....	13
Tabela 2: Pasqyra e Konsoliduar Financiare e NP-ve Qendrore 2016	14
Tabela 3: Performanca Operative e Sektorit të Energjisë Elektrike.....	16
Tabela 4: Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikimit	16
Tabela 5: Performanca Operative e Sektorit të Ujërave.....	17
Tabela 6: Performanca Operative e Sektorit të Ujërave.....	18
Tabela 7: Numri i Punëtorëve në NP-të Qendrore.....	19
Tabela 8: Performanca Vjetore Operative - Posta e Kosovës ShA.....	21
Tabela 9: Performanca Vjetore Financiare - Posta e Kosovës ShA.....	22
Tabela 10: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - Posta e Kosovës ShA.....	23
Tabela 11: Performanca Operative - Telekomuni i Kosovës ShA.....	26
Tabela 12: Performanca Vjetore Financiare – Telekomuni i Kosovës ShA.....	26
Tabela 13: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - Telekomuni i Kosovës ShA.....	27
Tabela 14: Performanca Vjetore Operative - KEK ShA.....	30
Tabela 15: Performanca Vjetore Financiare - KEK ShA.....	30
Tabela 16:Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KEK ShA.....	31
Tabela 17: Performanca Vjetore Operative – “TrainKos” ShA.....	33
Tabela 18: Performanca Vjetore Financiare - “TrainKos” ShA.....	33
Tabela 19: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - “TrainKos” ShA.....	34
Tabela 20: Performanca Vjetore Financiare - “InfraKos” ShA.....	36
Tabela 21: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare – “InfraKos” ShA.....	36
Tabela 22:Të Ardhurat dhe Pozita Financiare – Aeroporti i Gjakovës ShA.....	39
Tabela 23: Performanca Vjetore Operative - “Ibër Lepenc” ShA.....	41
Tabela 24: Performanca Vjetore Financiare – “ Ibër Lepenc” ShA.....	41
Tabela 25: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - “Ibër Lepenc” ShA.....	42
Tabela 26: Performanca Vjetore Operative - KMDK ShA.....	45
Tabela 27: Performanca Vjetore Financiare – KMDK ShA.....	45
Tabela 28: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KMDK ShA.....	46
Tabela 29: Performanca Vjetore Operative - KRU "Prishtina" ShA.....	49
Tabela 30: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Prishtina" ShA.....	50
Tabela 31: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KRU "Prishtina" ShA.....	50
Tabela 32: Performanca Vjetore Operative - KRU "Mitrovica" ShA.....	53
Tabela 33: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Mitrovica" ShA.....	54
Tabela 34: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KRU "Mitrovica" ShA.....	54
Tabela 35: Performanca Vjetore Operative - KRU "Hidromorava" ShA.....	58
Tabela 36: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Hidromorava" ShA.....	58

Tabela 37: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KRU "Hidromorava" ShA.	59
Tabela 38: Performanca Vjetore Operative - KRU "Hidrodrini" ShA.	62
Tabela 39: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Hidrodrini" ShA.	62
Tabela 40: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KRU "Hidrodrini" ShA.	63
Tabela 41: Performanca Vjetore Operative - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA.	65
Tabela 42: Performanca Vjetore Financiare - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA.	65
Tabela 43: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA.	66
Tabela 44: Performanca Vjetore Operative - KRU "Radoniqi" ShA.	68
Tabela 45: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Radoniqi" ShA.	68
Tabela 46: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KRU "Radoniqi" ShA.	69
Tabela 47: Performanca Vjetore Operative - KU "Drini i Bardhë" ShA.	71
Tabela 48: Performanca Vjetore Financiare - KU "Drini i Bardhë" ShA.	71
Tabela 49: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KRU "Drini i Bardhë" ShA.	72
Tabela 50: Performanca Vjetore Operative - KRU "Radoniqi-Dukagjin" ShA.	75
Tabela 51: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Radoniqi - Dukagjin" ShA.	75
Tabela 52: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - KRU "Radoniqi-Dukagjin" ShA.	76

Lista e Grafikonëve

Grafikoni 1: Ndarja e Tregut të Postës.....	22
Grafikoni 2: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare – Posta e Kosovës ShA.	24
Grafikoni 3: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - TK ShA.	28
Grafikoni 4: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KEK ShA.	31
Grafikoni 5: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare -“ TrainKos” ShA.	34
Grafikoni 6: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare – “InfraKos” ShA.	37
Grafikoni 7: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - NHE "Ibër Lepenc" ShA.	43
Grafikoni 8: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KMDK ShA.	47
Grafikoni 9: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU “Prishtina” ShA.	51
Grafikoni 10: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU “Mitrovica” ShA.	55
Grafikoni 11: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Hidromorava" ShA.	60
Grafikoni 12: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Hidrodrini" ShA.	63
Grafikoni 13: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA.	66
Grafikoni 14: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Radoniqi" ShA.	69
Grafikoni 15: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Drini i Bardhë" ShA.	72
Grafikoni 16: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Radoniqi-Dukagjin" ShA.	76

Lista e Figurave

Figura 1: Struktura Institucionale e Ushtrimit të Pronësisë në NP-të Qendrore.....	8
--	---

Lista e Shkurtesave

AB	Auditori i Brendshëm
AJ	Auditori i Jashtëm
ARKEP	Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare
BD	Bordi i Drejtorëve
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike
HK	Hekurudhat e Kosovës
HS	Hidro Sistemi (“Ibër-Lepenc”)
IPTV	Internet Protocol Television, ofrim i shërbimeve të telefonisë, internetit dhe televizionit përmes protokollit të internetit
KA	Komisioni i Auditimit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjetësimit
KUR	Kompania Ujësjetësi Rajonal
KURPRI	Kompania Ujësjetësi Rajonal “Prishtina” ShA
KURHJ	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Hidroregjioni Jugor”
KURHD	KRU “Hidrodrini” ShA
KURHM	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Hidromorava” ShA
KURRAD	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Radoniqi” ShA
KURMIT	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Mitrovica” ShA
KU	Kompania e Ujitjes
LNP	Ligji mbi Ndërmarrjet Publike
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
NJB	Njësi Biznesi
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
NJO	Njësia Operative
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PB	Plani i Biznesit
THSH	Të Hyrat nga Shitja
APTIZHA	Të Ardhurat Para Tatimit Interesit Zhvlerësimit dhe Amortizimit

Shqyrtime Hyrëse

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), sikurse në vitet paraprake, paraqet për shqyrtim para Kuvendit të Republikës së Kosovës, propozim Raportin mbi Performancën e Ndërmarrjeve Publike Qendrore për vitin 2016, i cili shqyrtohet paraprakisht edhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, kërkohet që të raportohet në baza vjetore në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të pasqyrit të saktë të performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2016, ky raport për dallim nga vitet tjera, dhe mbështetur në përvojën e zhvilluar të njësisë, dhe çështjeve të ngritura në lidhje me raportin paraprak, si dhe prioritetin strategjik të shprehur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, përmbanë risi që janë në funksion të raportimit sa më të mirë në harmoni me praktikën e mira të raportimit të korporatave në pronësi të shtetit. Përpilimi i këtij raporti është bazuar në raportet financiare të audituara nga ndërmarrjet si dhe nga raportet e rregullatorëve përkatës të miratuara nga Kuvendi.

Në këtë raport janë përfshirë tregues operativ dhe financiar për vitin 2016, ku të gjitha ndërmarrjet janë analizuar kundrejt planeve dhe krahasimet me vitin paraprakë.

Në kuadër të MZHE-së, funksionon edhe Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, e cila ka përgjegjësi ligjore të monitorojë dhe raportojë performancën e NP-ve në mënyrë individuale dhe kolektive.

Prandajë, mbi këtë bazë, kjo njësi ka përgatitur këtë raport i cili fokusohet në:

- Performancën operative (rezultatet e arritura, efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve);
- Performancën financiare (qarkullimin e arritur, efikasitetin e shpenzimeve dhe profitabilitetin);
- Qeverisjen e korporatave (monitorimet e punës së bordeve, llogaridhënien dhe planifikimin e biznesit).

Ky raport nuk përfshinë çështjet teknike të cilat i përkasin Ndërmarrjeve Publike, sepse informatat për çështjet e tilla gjenden në raportet vjetore individuale që gjenden në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Ky raport paraqet performancën e Ndërmarrjeve Publike nga perspektiva e aksionarëve dhe si aksionar për këtë periudhë kemi zgjedhur 3 pozicione kyçe financiare për monitorim gjatë periudhës së ardhshme. Pozicionet e tilla kyçe janë si në vijim:

- Paga bruto mesatare;
- Të Hyrat nga Shitja; dhe
- Kthimi në pasuri.

Këto pozicione janë zgjedhur për të siguruar një ekuilibër ndërmjet shpenzimeve që janë përgjegjësi e ndërmarrjeve, Të Hyrave nga Shitja që është përgjegjësi e ndarë ndërmjet ndërmarrjes

përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe konsumatorit (publikut) dhe kthimi në pasuri që tregon se sa është në gjendje ndërmarrja të jetë e vetëqëndrueshme për vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve.

Politikat e Pronësisë mbi Ndërmarrjet Publike


Ndërmarrjet Publike në Kosovë janë në pronësi të institucioneve ekzekutive shtetërore, prej të cilave në vitin raportues (2016) janë 16 në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, Qeveria e Republikës së Kosovës ka kompetencat ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit në korporatat me aksione në pronësi të saj, të cilat janë të cilësuara si Ndërmarrje Publike Qendrore. Në rastin e korporatave me aksione në pronësi të komunave, të cilësuara si Ndërmarrje Publike Komunale, komnatat të drejtat e tyre të pronësisë i ushtrojnë përmes Komisioneve të Aksionarëve. Ky ushtrim i të drejtave si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal përcaktohet me Ligjin për Ndërmarrjet Publike (i ndryshuar kohë pas kohe).

Sipas ligjit të lartë përmendur, Qeveria e Republikës së Kosovës garanton dhe punon në drejtim të sigurimit të Shoqëritë Aksionare në pronësi të saj vepron në tregjet përkatëse në harmoni me parimet e neutralitetit konkurrues, dhe zbatimit të standardeve të mira të qeverisjes korporative.

Në anën tjetër, strukturat korporative të Shoqërive Aksionare në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës përqendrohen në menaxhim efikas, ekonomik dhe efektiv të pasurive të tyre në drejtim të maksimizimit të performancës financiare dhe rrjedhimisht, përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga këto korporata për publikun.

Për këtë qëllim, kuadri ligjor për Ndërmarrjet Publike përcakton një politikë të ushtrimit të pronësisë përmes një kuadri institucional si në Figurën 1 në vijim.

Figura 1: Struktura Institucionale e Ushtrimit të Pronësisë në NP-të Qendrore



Si pjesë e detyrave funksionale të monitorimit dhe raportimit të performancës sektoriale dhe individuale është përgatitja e

Raportit Vjetor të Performancës të Ndërmarrjeve Publike nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Ky

raport për vitin 2016 përqendrohet në analizën e tri shtyllave:

- Funksionimi i qeverisjes korporative;
- Performanca operative, dhe
- Performanca financiare.

Gjithashtu, në harmoni me synimet e Qeverisë për të përmirësuar vetëqëndrueshmërinë e Ndërmarrjeve Publike, janë paraqitur tendencat për tri vitet

Zhvillimi i Qeverisjes Korporative

Që nga viti 2006 të gjitha Ndërmarrjet Publike janë korporatizuar dhe shndërruar në Shoqëri Aksionare të cilat funksionojnë sipas qeverisjes korporative të përcaktuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike të cilat janë të bazuara në parimet e OECD të Qeverisjes Korporative.

Sipas këtyre parimeve Ndërmarrjet Publike qeverisen nga një bord, përbërja e të cilit zgjedhet nga Aksionari – Qeveria. Bordet janë përgjegjëse në mënyrë kolektive për suksesin e ndërmarrjes. Në këtë kontekst, Qeveria lejon bordin të ushtrojë përgjegjësitë e veta mbikëqyrëse dhe respekton pavarësinë e tij konform kuadrit ligjor duke lejuar drejtimin e Ndërmarrjeve Publike në autonomi të plotë operative për të zbatuar Strategjitë e vendosura nga Bordi i Drejtorëve, si dhe për të arritur objektivat përkatëse të përcaktuara. Nga ana tjetër, Qeveria përmes raporteve vjetore sigurohet nëse Ndërmarrjet Publike kanë përmbushur interesat e të gjitha grupeve të interesit për të arritur një rritje të qëndrueshme, jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në aspekte të përgjithshme ekonomike duke pasur parasysh qëllimin e tyre kryesor që të veprojnë në interesin më të mirë të përgjithshëm të të

e fundit për tri pozicione kyçe financiare të përzgjedhura si në vijim:

- Paga mesatare mujore (bruto);
- Të Hyrat e Shitjes; dhe
- Kthimi në pasuri.

gjithë qytetarëve të Kosovës, që në të njëjtën kohë janë edhe konsumatorë të tyre.

Gjatë vitit 2016, me qëllim të plotësimit të përgjegjësisë që i përcakton Ligji për Ndërmarrje Publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ka përmbushur detyrat si në vijim:

- Është monitoruar puna e Bordeve të Drejtorëve përmes shqyrtimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordeve të Drejtorëve, komiteteve të auditimit dhe komiteteve tjera. Më konkretisht, gjatë vitit 2016, për gjashtëmbëdhjetë (16) Ndërmarrje Publike Qendrore që janë monitoruar nga NJPMNP, janë mbajtur:
 - 16 mbledhje të përgjithshme vjetore me Aksionarin në qershor të 2014;
 - 219 mbledhje të Bordeve të Drejtorëve;
 - 179 mbledhje të Komisioneve të Auditimit; dhe
 - 52 mbledhje të komiteteve të përkohshme të bordit.

Përgjegjësitë e bordit dhe numri i mbledhjeve të bordit brenda vitit janë të rregulluara me pikën 24 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, sipas së cilit bordi për të kryer përgjegjësitë duhet të takohet rregullisht, por të paktën dymbëdhjetë (12) herë brenda një viti, ndërsa Pikat 20.5 e Kodit rregullon që tri ditë para çdo mbledhje të bordit, Komisioni i Auditimit do të takohet për të shqyrtuar dokumentet strategjike dhe pikat tjera dhe më pastaj për të rekomanduar ose jo bordit për miratim.

Sa i përket Ndërmarrjes Publike Aeroporti i Gjakovës i themeluar si NP me vendimin e Qeverisë Nr. 06/180 të datës 24 mars 2014, Qeveria ka emëruar Bordin e Drejtorëve që ka marrë përgjegjësinë; mirëpo, kjo NP nuk ka filluar akoma ndonjë operim për të ofruar shërbime publike që do të krijonte të hyra. Për këtë arsye, për vitin 2016, me vendime të Qeverisë, janë ndarë mjete financiare për të mbuluar shpenzimet për sigurimin fizik të objekteve të aeroportit, shërbimet komunale dhe mirëmbajtjen.

Më tutje,

- Analistët e NJPMNP gjatë vitit 2016 në cilësinë e vëzhguesit në emër të aksionarit kanë marrë pjesë në 32 mbledhje të Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike dhe në 10 mbledhje të Komisionit të Auditimit;
- Janë pranuar, përpunuar dhe janë ekzekutuar pagesa për Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Lokale për realizimin e projekteve investive të sektorit të hekurudhave, ujit të pijes, ujitjes, dhe mbeturinave në vlerë prej 11.2 mil. euro të financuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës gjatë vitit 2016;

- Janë pranuar, përpunuar dhe janë ekzekutuar pagesat për kërkesa të Ndërmarrjeve Publike Qendrore dhe Lokale për subvencionimin e rasteve sociale për furnizim me energji, blerjes së mazutit për ngrohje, shërbimeve të ujit dhe mbeturinave, mbulimit të kostos operative të lëvizjes së trenit të lirë për qytetarët dhe infrastrukturë hekurudhore të gjitha në vlerë prej 7.5 mil. euro;
- Janë organizuar dhe përgatitur tri (3) mbledhje të Komisionit të Ministrave për NP-të, në të cilat janë diskutuar shumë çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e NP-ve.
- Është azhurnuar rregullisht me informata të NP-ve faqja elektronike e MZHE – NJPMNP për NP-të Qendrore duke publikuar:
 - Planet e Biznesit;
 - Raportet vjetore;
 - Raportet e Auditorit të Jashtëm;
 - Dhe dokumente tjera që kërkohen me ligj dhe praktikat e informimit për Shoqëri Aksionare;
- Janë pranuar dhe përpunuar raporte tremujor dhe vjetore të NP-ve;
- Janë përgatitur përgjigje për pyetjet e arritura parlamentare dhe të mediave mbi çështjet e NP-ve Qendrore;
- Janë dhënë opinione ligjore me kërkesën e MAPL mbi vendimet e Asambleve Komunale mbi NP-të Lokale;

- Pjesëmarrje aktive në Komisionet Drejtuese të Projekteve të donatorëve të sektorit të ujërave të financuara nga

Qeveria e Zvicrres dhe Luksemburgut.

Kuadri Ligjor

Pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është miratuar korniza bazë për rregullimin pronësor dhe funksionimin e Qeverisjes Korporative të Ndërmarrjeve Publike në Kosovë Nr. 03/L-087, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/009.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik përmes Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në drejtim të zbatimit të kornizës ligjore, ka përpiluar akte nënligjore si në vijim:

- Rregullorja Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, dhe Plotesim ndryshimi i Rregullores Nr. 19/2015;
- Udhëzimi Administrativ mbi Pjesëmarrjen e Komunave në Bordet e Kompanive Rajonale të Mbeturinave në vitin 2009- Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i menyrës së përfaqësimit të komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale;
- Rregullorja mbi Punën e Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike

(2011)- Nr. prot. 1674 i datës 28.09.2011, nxjerrë nga Kryesuesi i Komisionit për NP dhe njëherish Ministri i Zhvillimit Ekonomik-Qëllimi i kësaj Rregullore të Punës, është rregullimi i përbërjes së Komisionit të Ministrave për Ndërmarrjet Publike (në tekstin e mëtejme KMNP), përcaktimi i detyrave dhe përgjegjesive të anëtareve, si edhe mënyra e vendimmarrjes dhe raportimit.

Dokumentet tjera në zbatim të Ligjit për Ndërmarrjet Publike janë:

- Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike;
- Politikat Pronësore për Ndërmarrje Publike - miratuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.11/39 i datës 08.10.2008;
- Procedurat për mbikëqyrjen dhe monitorimin e Ndërmarrjeve Publike Qendrore- me Nr. prot.238 i datës 09.02.2012 nxjerrë nga Drejtori i NJPMNP.

Objektivat e Korporatës dhe Aktivitetet e Biznesit

Drejtimi ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin efektiv të Ndërmarrjeve Publike,

i cili përfshinë përgjegjësi ekzekutive, krijim vlerash, përdorim me efikasitet, ekonomi dhe

efektivitet të të hyrave të tyre në të mirën e publikut, vendosjen e objektivave, taktikave operacionale, menaxhimin e rreziqeve dhe kontrolleve dhe matjen e performancës. Ndërsa Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për të vendosur rregulla dhe standarde që

Struktura e Kapitalit

Struktura e kapitalit të korporatave duhet të jetë adekuate për nevojat e biznesit të korporatave, andaj duhet të rishikohet në baza të rregullta nga Aksionari, Bordi i Ndërmarrjes dhe Njësia e NP-ve. Në këtë aspekt duhet të përmendet se gjatë viteve të fundit disa prej Ndërmarrjeve Publike kanë diversifikuar strukturën e kapitalit duke siguruar financim përmes borxhit për rritjen e

sigurojnë përmbushjen e rolit të Bordit të Drejtorëve si monitorues ndaj NP-ve.

Për të mundësuar përmbushjen e objektivave gjatë vitit 2015 janë hartuar dhe më pas janë miratuar të gjitha Planet e Biznesit të NP-ve në afatin ligjor në fund të tetorit të vitit 2016.

pasurive të tyre në funksion të ofrimit të shërbimeve më të mira për konsumatorët – publikun. Kjo ka rezultuar me nevojë për fuqizim të vetëqëndrueshmërisë të atyre ndërmarrjeve përmes një mbikëqyrje më të mirë me qëllim të sigurimit të servisimit të borxhit, dhe vazhdimësisë së aktiviteteve të tyre, si dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve.

Opinionet e Auditorëve të Jashtëm

Tabela 1: Krahasimi i Opinioneve të Auditorëve të Jashtëm 2015-2016

Emri i Ndërmarrjes	Opinionimi 2015	Opinionimi 2016
Posta e Kosovës ShA	Pakualifikuar	Pakualifikuar
Telekomi i Kosovës ShA	Pakualifikuar me theksim çështje	- ¹
Aeroporti i Gjakovës	-	Refuzim Opinioni
KEK ShA	Pakualifikuar me theksim çështje	Pakualifikuar me theksim çështje
“TrainKos”	Pakualifikuar me theksim çështje	Opinion i kundërt
“InfraKos”	Pakualifikuar	Pakualifikuar me theksim të çështjes
“Ibër Lepenc” ShA	Pakualifikuar me theksim të çështjes	Kualifikuar
KMDK ShA	Pakualifikuar	Kualifikuar
KUR “Prishtina” ShA	Kualifikuar	Opinion me rezervë
KRU “Mitrovica” ShA	Opinion me rezervë	Opinion me rezervë
KRU “Hidromorava” ShA	Kualifikuar	Kualifikuar
KRU “Hidrodrini” ShA	Opinion me rezervë	Opinion me rezervë
KRU “Hidroregjioni Jugor” ShA	Pakualifikuar me theksim çështje	Pakualifikuar me theksim çështje
KRU “Radoniqi” ShA	Kualifikuar	Pakualifikuar
KRU “Drini i Bardhë” ShA	Opinion i kundërt	Refuzim i Opinionit
KRU “Radoniqi-Dukagjin” ShA	Kualifikuar	Opinion me rezervë

Nga Tabela më lartë shihet se nga gjashtëmbdhjetë (16) ndërmarrje, dy (2) prej tyre kanë opinion të pakualifikuar nga Auditori i Jashtëm, tre (3) prej tyre kanë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, tre (3) kanë opinion të kualifikuar, një (1) opinion të kundërt, katër (4) opinione rezervë dhe dy (2) refuzim opinioni.

¹ Telekomi i Kosovës nuk ka bord të Drejtorëve dhe për këtë arsye nuk është aprovuar raporti i auditorit të jashtëm.

Performanca e Ndërmarrjeve

Tabela 2: Pasqyra e Konsoliduar Financiare e NP-ve Qëndrore 2016

Emri i Ndërmarrjes	Pasuritë ('000)	Ekuiteti ('000)	Detyrimet ('000)	Të hyrat ('000)	Shpenzimet ('000)	APTIZHA ('000)	Fitimi/Humbja ('000)
Posta e Kosovës ShA	18,870	15,993	2,737	12,213	(13,798)	378	(1,585)
Telekomi i Kosovës SHA	124,062	74,551	49,511	76,000	(107,311)	(8,254)	(31,311)
Korporata Energjetike e Kosovës SHA	417,581	101,885	315,696	169,353	(158,355)	56,677	10,998
Aeroporti i Gjakovës SHA	9,385	25	56	706	(706)	504	0
Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" ShA	9,279	5,003	5,056	3,151	(4,338)	(202)	(1,187)
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - "InfraKos" ShA	23,381	13,646	9,725	2,931	(3,947)	196	(1,016)
Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" ShA	125,252	124,367	885	3,882	(8,277)	257	(4,395)
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë ShA	5,488	4,483	1,005	1,851	(2,359)	371	(508)
Kompania Rajonale e Ujësullësit "Prishtina" ShA	126,985	62,596	64,389	15,149	(14,303)	4,706	846
Kompania Rajonale e Ujësullësit "Mitrovica" ShA	43,609	27,336	16,273	4,626	(4,793)	1,069	(167)
Kompania Rajonale e Ujësullësit "Hidromorava" ShA	12,524	6,992	5,532	3,263	(3,337)	542	(74)
Kompania Rajonale e Ujësullësit "Hidrodrini" ShA	32,825	20,276	12,549	4,002	(3,999)	1,595	3
Kompania Rajonale e Ujësullësit "Hidroregjioni Jugor" ShA	20,673	8,266	12,407	4,794	(5,001)	1,048	(207)
Kompania Rajonale e Ujësullësit "Radoniqi" ShA	37,379	31,601	5,778	4,201	(4,734)	1,144	(533)
Kompania Rajonale e Ujitjes "Drini i Bardhë" ShA	4,063	1,393	2,670	460	(345)	243	115
Kompania Rajonale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" ShA	4,132	3,550	583	855	(840)	216	16
Gjithsej	1,015,488	501,963	504,852	307,437	(336,443)	60,490	(29,005)

Në këtë Tabelë, shihet që totali i vlerës kontabël të pasurive të Ndërmarrjeve Publike në pronësi të nivelit qendror në vitin 2016 është 1,015 mil. euro apo 16.4% më e ulët se në vitin 2015. Ekuiteti është 502 mil. euro apo 18.4% më e ulët se vitin 2015, ndërsa detyrimet janë në vlerë prej 505 mil. euro apo 16.1% më të ulëta se në vitin 2015.

Përsa i përket të hyrave totale të Ndërmarrjeve Publike në vitin 2016 kanë qënë 307 mil. euro apo 7% më pak se vitin paraprak. Ndërsa shpenzimet kanë qënë 336 mil. euro apo 1.9% më të larta se vitin 2015.

Performanca e NP-ve sipas Sektorëve

Sektori i Energjisë

Dihet se në sektorin e energjisë elektrike rezultatet e angazhimit nuk vërehen menjëherë. Në këtë aspekt, shfrytëzojmë rastin të paraqesim të arriturat e realizuara gjatë kësaj periudhe, që jepen në formë të një retrospektive të qartë të punës së kaluar.

Tabela 3: Performanca Operative e Sektorit të Energjisë Elektrike

Indikatorët Operativ	Nxjerrja e linjtit në ton (000)	Prodhimi i Energjisë (MWh)
2015	8,240	5,361
2016	8,801	5,601

Nga Tabela vërehet se tek sektori i energjetikës për gjenerim, energjia ka një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2015 prej 4%. Po ashtu kemi edhe një rritje të nxjerrja e linjtit për 7% nga viti paraprak.

Sektori i Telekomunikimit

Sipas raportit të ARKEP për vitin 2015, numri i përdoruesve të telefonisë mobile në Kosovë ka arritur në 1,77 milion apo 97,7% në shkallë të penetrimit. Nga këta përdorues:

- Vala - 55,6%;
- IPKO – 34,9%; dhe
- Z-Mobile – 9,46%.

Në aspektin e të hyrave, Vala vazhdon të prijë me rreth 58,45% të të hyrave në treg.

Këto të dhëna janë për vitin 2015, ndërsa për vitin 2016 nuk kemi të dhëna kredibile meqenëse raporti i ARKEP nuk është aprovuar në kuvend.

Mirëpo, në sektorin e telekomunikacionit kemi një konkurrencë të qartë në treg dhe kjo vërehet edhe nga të dhënat e NP-ve Telekom që janë të paraqitura me poshtë, ku shohim një rënie në numrin e konsumatorëve të telekomit, internetit si dhe operatorit mobil Vala.

Tabela 4: Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikimit²

Indikatorët Operativë	Telefonia (Telekomi) Nr. Konsumatorëve	Fikse (Vala) Nr. Konsumatorëve	Telefonia Mobile Nr. Konsumatorëve	Interneti Nr. Konsumatorëve
2015	60,808	1,773,855		35,542
2016	42,187	1,209,538		33,214

² Të dhënat në këtë tabelë janë marrë nga raporti vjetor 2016 të TK

Sektori i Ujit

Ndërmarrjet e Sektorit të Ujit, kryesisht ato për furnizim me ujë të pijshëm gjatë vitit 2016 në nivel të sektorit kanë shënuar një rritje të të hyrave për 6.9% në krahasim me vitin paraprak.

Në përgjithësi, pozicioni financiar i konsoliduar i ndërmarrjeve të furnizimit me ujë tregon se vlera totale e pasurive është 273,995 mil. euro që shënon një rritje prej 2.7% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa vlera e ekuitetit është rreth 157,067 mil. euro apo 1.3% më e lartë se vitin 2015. Në anën tjetër detyrimet në vlerë prej 116,938 mil. euro tregojnë rritje 8% në krahasim me vitin paraprak.

Mbulueshmëria me shërbime të ujit

Mbulueshmëria me shërbime të ujit nënkupton përqindjen e popullatës brenda zonës së shërbimit të ofruesve të licencuar të shërbimeve të cilët ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Në zonën e shërbimeve të ofruesve të shërbimeve, vlerësohet se jetojnë një popullatë prej 1.7mil. banorë, prej të cilëve rreth 1,5 mil. banorë apo 91% marrin shërbime të ujësjellësit. Pjesa tjetër e popullatës banojnë kryesisht në zonat rurale, të cilat kanë ujësjellës të veçantë apo sisteme individuale, të cilat nuk menaxhohen nga ofruesit e shërbimeve. Qasje në shërbimet e ujërave të ndotura kanë rreth 1.2 mil. banorë apo 69.5%.

Tabela 5: Performanca Operative e Sektorit të Ujërave

Mbulueshmëria me shërbime Ujësjellës dhe kanalizime	Ujësjellës %	Ujëra të ndotura %
2015	87	65
2016	91	69,5

Siq shifet nga Tabela e mësipërme, mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit për shtatë ofruesit e shërbimeve në vitin 2016 është 91%, dhe është 4% më e lartë se në vitin paraprak. Në të gjitha zonat e shërbimit të ofruesve të shërbimeve ka rritje të qasjes së popullatës në shërbime të ujësjellësit.

Ndërsa mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura për shtatë ofruesit e shërbimeve në vitin 2016 është 69.5%, dhe është për 4.5% më e lartë se në vitin paraprak.

Të dhëna të performancës operative të sektorit 2015-2016, duke përfshirë edhe të dhënat KRU “Bifurkacioni” ShA që nuk është në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës është si në vijim.

Tabela 6: Performanca Operative e Sektorit të Ujërave

Treguesit Operativ ³	2015	2016
Prodhimi i ujit (m3)	137,044	143,737
Faturimi i ujit (%)	44	44
Inkasimi i ujit (%)	74	86
Uji i pafaturuar (%)	56	57
Testet e dështuara të ujit (%)	2,8	2,0
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës	92	92
Numri i konsumatorëve	305,855	327,286

Nga të dhënat e lartë cekura mund të konkludojmë se sektori ka arritur të realizojë objektivin e sasisë së ujit të prodhuar, Inkasimit dhe numrit të konsumatorëve të shërbyer, ndërsa ka dështuar në zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe në ngritjen e përqindjes së ujit të faturuar.

Uji i Pafaturuar (UPF) paraqet ujin i cili është prodhuar, është shpërndarë por nuk është faturuar (nuk ka arritur të regjistrohet), ndryshe quhet si “humbje e ujit”.

Niveli i lartë i UPF ndikon negativisht në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe vazhdon të jetë ndër shqetësimet kryesore të sektorit.

Niveli i ujit të pafaturuar në mesatare të sektorit, në raport me ujin e prodhuar dhe distribuuar të konsumatorët, gjatë vitit 2016, shprehur në përqindje, është në nivelin 57%. Në krahasim me vitin 2015, ky tregues ka shënuar zhvillim negativ me rritje 1%.

Sa i përket numrit të konsumatorëve, në vitin 2016 është shënuar një rritje prej 21,431 konsumatorë në krahasim me vitin 2015. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i zgjerimit të rrjeteve nëpër zonat rurale.

Sa i përket, mbulimit me ujëmatës për konsumatorët shtëpiak ka mbetur në 92% që është nivel i njëjtë me vitin paraprak. Në këtë aspekt, prinë KRU “Prishtina” me 97%, ndërsa KRU “Mitrovica” mbetet në nivel prej vetëm 64%.

³ Burimi: Raporti Vjetor ARRU, 2016

Punësimi në Ndërmarrje Publike

Ndërmarrjet Publike Qendrore në vitin 2016 kanë raportuar gjithësej 10,152 të punësuar apo rreth 3,1% të totalit të punësuarve në Republikën e Kosovës në të njëjtin vit⁴.

Tabela 7: Numri i Punëtorëve në NP-të Qendrore

Emri i Ndërmarrjes	2015	2016	Ndryshimi 2016-2015
1 Posta e Kosovës ShA	1,010	1,002	-8
2 Telekom i Kosovës SHA	2,293	2,274	-19
3 Korporata Energjetike e Kosovës SHA	4,619	4,144	-475
4 Aeroporti i Gjakovës SHA	-	10	-
5 Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" ShA	231	236	5
6 Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - "InfraKos" ShA	317	324	7
7 Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" ShA	270	276	6
8 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë ShA	73	77	4
9 Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Prishtina" ShA	544	543	-1
10 Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Mitrovica" ShA	219	231	12
11 Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Hidromorava" ShA	151	153	2
12 Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Hidrodrini" ShA	216	214	-2
13 Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Hidroregjioni Jugor" ShA	305	319	14
14 Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Radoniqi" ShA	254	255	1
15 Kompania Rajonale e Ujitjes "Drini i Bardhë" ShA	44	33	-11
16 Kompania Rajonale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjini" ShA	62	61	-1
Gjithsej	10,608	10,152	-456

Nuk mund të bëjmë një krahasim real me vitin paraprak 2015 pasi që NP KOSTT sipas Ligjit Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike, funksionon si Ndërmarrje Publike në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmisionit ushtrohen sipas Ligjit për Enënergjinë Elektrike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Po ashtu, këtë vit kemi NP Aeroporti i Gjakovës, ndërmarrje kjo e cila ka filluar veprimtarinë e saj në vitin 2016.

⁴ Burimi: Të dhënat e punësimit, Agjencia e Statistikave të Kosovës

Raportet Individuale të Performancës

Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Posta e Kosovës ShA
Nr. i Biznesit 70847701	Nr.Fiskal 600815924
Kryeshefi Ekzekutiv:	Sejdi Hoxha
Auditori i Jashtëm:	“Alb Audit” ShPK

Përbërja e Bordit	Nga 9 Shtator 2015
Kryesues Bordi	Halit Isufi
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Hysen Fazliu
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Branislav Nikoliq
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Rushan Ceku
Anëtar Bordi	Mejdi Xhokli

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsejë
45,211	6,000	2,430	22,800	76,441

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Posta e Kosovës ShA, si operator i vetëm publik postar, aktivitetin e vet e zhvillon në mbarë territorin e Kosovës. E organizuar në 7 regjione, e bën shpërndarjen e të gjitha dërgesave që arrijnë nga bota në Kosovë dhe anasjelltas, si dhe të atyre që grumbullohen në Kosovë dhe kanë për destinim qendrat e ndryshme të Kosovës.

Nga ana tjetër, shërbimet e Posta e Kosovës ShA kryhen në mbi 155 Zyra Postare, ku mblidhen edhe dërgesat postare, të cilat pas përpunimit në Qendren Tranzite Postare (QTP) rrugëtojnë nëpër shtete të ndryshme të botës (dërgesat me destinim ndërkombëtar), ndërsa ato që janë me destinim vendor shpërndahen në regjione.

Aktivitetet biznesore të Posta e Kosovës ShA janë të përqendruara në ofrimin e produkteve/shërbimeve postare, shitjen e produkteve/shërbimeve të telekomit, shërbime komerciale për subjekte juridike (biznese), si dhe shitjen e organizuar për konsumatorë të mëdhenjë dhe për konsumatorë spontanë nëpër Zyra Postare. Por, synimi është që Posta e Kosovës ShA ta zgjerojë rrjetin e shitjes (Zyra Postare) për ofrimin e shërbimeve aktuale, si dhe ta zgjerojë gamën e produkteve/shërbimeve duke zhvilluar shërbime të reja, si p.sh. zgjedhja ligjistrike si transporti që lidhet ngushtë me këtë veprimtari, si dhe me objektin parësor të Posta e Kosovës ShA të ofrojë pako shërbimesh sa më efektive, kualitative dhe efikase për konsumatorë.

Shërbimet financiare jobankare janë një shërbim tjetër që Posta e Kosovës ShA ka filluar ta ushtrojë në shkurt të vitit 2014 pas marrjes së licensës nga Banka Qendrore e Kosovës.

Misioni

Misioni i Postës së Kosovës është që të ofrojë shërbime postare dhe shërbime tjera komerciale për qytetarët, bizneset, institucionet dhe organizatat e ndryshme në tregun vendor dhe atë ndërkombëtar, duke ofruar shërbime të standardeve të larta dhe shërbime inovative në hap me kërkesat e tregut, krahas zhvillimeve të reja në teknologjinë informative.

Vizioni

Vizioni i Postës së Kosovës ShA është që përmes ngritjes së cilësisë së shërbimeve postare dhe zgjerimit të gamës së shërbimeve tjera komerciale, të njihet për cilësi dhe besueshmëri jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë, duke përmbushur kërkesat e Bashkimit Evropian për cilësinë dhe standardet.

Qëllimi kryesor afatmesëm i Postës së Kosovës ShA është ngritja e cilësisë dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve postare dhe komerciale në Kosovë dhe më gjerë, duke siguruar vetëqëndrueshmëri financiare, kjo parashihet të arrihet përmes këtyre objektivave:

- Menaxhimi efikas i resurseve dhe mjeteve të PK-së;
- Uljen e shpenzimeve operative;
- Ngritja e të hyrave të PK-së.

Performanca Operative

Tabela 8: Performanca Vjetore Operative - Posta e Kosovës ShA⁵

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Realizimi 2016
Postë Vendore	6,257,334	6,514,643
Postë Ndërkombëtare	709,310	744,516
Postë Vendore + Ndërkombëtare	6,966,644	7,259,159

Në bazë të krahasimeve të paraqitura më lartë NPQ Posta e Kosovës SHA, edhe më tutje konsiderohet dhe mbetet lidere në tregun e shërbimeve postare, përkatësisht në ofrimin e shërbimeve universale postare si dhe shërbimet tjera postare në Republikën e Kosovës me volumin – numrin më të madh të artikujve – dërgesave postare, dhe atë me rreth; 7,259,159; artikuj – dërgesa postare, nga të cilat rreth; 6,514,643; artikuj – dërgesa postare, kishin për destinim trafikun vendor, respektivisht postën vendore, ndërsa rreth; 744,516; artikuj – dërgesa postare, ishin të destinuara për trafikun ndërkombëtar në shkurje dhe ardhje.

⁵ Pasqyra e Përgjithshme e Tregut të Shërbimeve Postare në Republikën e Kosovës për vitin 2016

Grafikoni 1: Ndarja e tregut të Postës



Nga figurat më lartë vërehet se bazuar në numrin e përgjithshëm të dërgesave postare rreth; 96.1%, të dërgesave janë pranuar dhe shpërndarë nga NPQ Posta e Kosovës SHA, ndërsa rreth: 3.9%, janë pranuar dhe shpërndarë nga operatorët privat. Ndërsa, nga numri i përgjithshëm i dërgesave postare rreth; 89.3%, e numrit të dërgesave postare, kanë pasur për destinacion trafikun e brendshëm – të postës vendore, ndërsa vetëm; 10.7%, e numrit të përgjithshëm të dërgesave postare, kanë pasur për destinacion trafikun ndërkombëtar.⁶

Performanca Financiare

Tabela 9: Performanca Vjetore Financiare - Posta e Kosovës ShA

Indikatorët Financiarë (000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	10,678	12,357	12,213
Shpenzimet	(13,722)	(13,688)	(13,798)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	(2,061)	(2,076)	1,963
Borxhet e këqija	0	-	
APTIZHA	(983)	745	378
Të ardhurat neto	(3,044)	(1,331)	(1,585)
Paraja në fund të vitit	1,082		954
Mjetet themelore	16,667	15,841	15,161

Performanca Financiare e Posta e Kosovës ShA e vitit 2016, siç shihet në Tabelën më sipër ka shënuar lëvizje ndërmjet caqeve dhe realizimit, si më poshtë:

- Të hyrat e realizuara janë 1.2% më të ulëta se plani;
- Shpenzimet në fund të vitit janë 0.8 % më të larta se sa plani;
- Të Ardhurat Para Tatimit Interesit Zhvlerësimi të realizuara janë pozitive, mirëpo krahasuar me planifikimin ato janë për 49% më të ulëta.

⁶ Pasqyra e Përgjithshme e Tregut të Shërbimeve Postare në Republikën e Kosovës për vitin 2016

Si rrjedhim, Posta e Kosovës ShA si rezultat i një performance të tillë financiare ka përfunduar vitin 2016 me pozicione financiare si në Tabelën në vijim:

Tabela 10: Të Ardhurat dhe Pozita Financiare - Posta e Kosovës ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	10,678	12,213	Pasuritë	20,664	18,870
Të hyrat e shitjes	10,547	12,053	Mjetet themelore	16,667	15,161
Të hyra tjera	131	160	Ekuiteti	17,577	15,993
Shpenzimet	13,722	13,798	Detyrimet	3,087	2,737
Zhvlerësimi	2,061	1,963	Kreditë	-	
Shpenzimet për paga	9,209	9,075	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	2,452	2,760	Kthimi në pasuri	-14.73	-8.40
Të dala tjera	-	-	Kthimi në ekuitet	-17.32	-9.02
APTIZHA	(983)	378	Kontributi nga aksionari ('000)	300	100
Të ardhurat neto	(3,044)	(1,585)	Subvencion	-	-
Nr. i punëtorëve	1,010	1,002	Projekte Kapitale	300	100


Posta e Kosovës ShA vitin 2016 e ka përfunduar me rezultat financiar negativ dhe me një kthim në pasuri prej -8.4 % që është më i ulët se në vitin 2014. Gjithashtu edhe Të Ardhurat Para Tatimit Interesit Zhvlerësimi dhe Amortizimit (APTIZHA) kanë shënuar përmirësim për 138% në krahasim me realizimin e vitit paraprak.

Sa i përket Të hyrave të Shitjes, Posta e Kosovës në vitin 2016 ka realizuar Të Hyra nga Shitja në vlerë prej 12.053 mil. euro ose 14.2 % më shumë se në vitin 2015. Kjo rritje kryesisht i atribuohet rritjes të të hyrave nga marrëveshjet me konsumatorët e mëdhenjë dhe nga rritja e të hyrave nga qiraja që përbën një pjesë të konsiderueshme të Të Hyrave të Shitjes të kësaj kompanie.

Ndërsa te shpenzimet, Posta e Kosovës ShA ka shënuar një rritje të lehtë të shpenzimeve totale prej 0.8% në krahasim me vitin paraprak. Mirëpo duhet theksuar se kemi një rënie të shpenzimeve të pagave prej 1.4%, ani pse shpenzimet e pagave zënë 65.8% të shpenzimeve totale dhe 75.3% të totalit të Të Hyrave të Shitjes. Si rezultat i pozicioneve të tilla, pasuritë e Postës së Kosovës ShA gjatë vitit 2016 janë tkurrur për 8.7% edhe pse të hyrat e dhënies me qira të objekteve që përbëjnë pjesën më të madhe të pasurive tejkalojnë shkallën vjetore të zhvlerësimit të tyre.

Gjithashtu, një tkurrje prej 9% shënohet edhe në pozicionin e ekuitetit, ndërsa pozicioni i detyrimeve në krahasim me vitin paraprak ka shënuar një rritje prej 11%.

Grafikoni 2: Tendenca e Pozicioneve Kyçe Financiare – Posta e Kosovës ShA



Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Telekomi i Kosovës ShA
Nr. i Biznesit	70280741
Nr.Fiskal	600016762
Kryeshefi Ekzekutiv:	Agron Mustafa
Auditori i Jashtëm:	Grant Thornton ShPK

Përbërja e Bordit	Nga 27.12.2013
Kryesues Bordi	Rexhe Gjonbalaj
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Afrim Loku
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Gani Sylaj
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Bislim Zogaj
Anëtar Bordi	Naim Hyseni
Anëtar Bordi	Suzana Angjelkovic – Kryeziu

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
39,687	5,919	4,920	23,100	73,626

Veprimtaria e Ndërmarrjes

PTK, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës është një kompani e cila në organizimin e saj të brendshëm përbëhet nga dy njësi operative siç janë: Telekomi i Kosovës dhe operatori i telefonisë mobile Vala. Këto njësi ofrojnë shërbime të telefonisë mobile dhe fikse, internet, televizion si dhe shërbime të menaxhuara të teknologjisë informative për konsumtorë biznesi.

Operatori i telefonisë mobile Vala ka shtrirë rrjetin e saj pothuaj se në tërë territorin e Kosovës, dhe që një kohë të gjatë ofron për të gjithë konsumatorët e saj shërbimet më të avancuara të telefonisë mobile, brenda dhe jashtë operatorit Vala.

Telekomi i Kosovës ka shndërruar rrjetin e vet analog me atë të gjeneratës së ardhshme (NGN), duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të telefonisë, interneti dhe televizionit përmes protokollit të internetit (IPTV).

Njësitë e biznesit të PTK-së janë të licencuara nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit të Kosovës.

Misioni

Vizioni i PTK-së është të jetë forcë shtytëse në rritjen e prosperitetit të kombit dhe pasurimit të jetës të të gjithë kosovarëve.

Vizioni

Misioni i PTK-së është të jetë gjithmonë prijëse në ofrimin e shërbimeve superiore të komunikimit, që ua përmirësojnë jetën të gjithë kosovarëve, përmes pasionit të njerëzve tanë dhe përmes përdorimit të teknologjisë më bashkëkohore të sprovuar.

Performanca Operative

Tabela 11: Performanca Operative - Telekom i Kosovës ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Realizimi 2016
Nr. i Konsumatorëve(Telekomi)	56,323	42,187
Nr. i Konsumatorëve (VALA)	1,055,391	1,209,538
Nr. i Konsumatorëve (Interneti)	38,149	33,214

Telekomi i Kosovës ShA gjatë vitit 2016 ka shënuar një performancë operative siç është paraqitur në Tabelën më lartë. Aty shihet se numri i konsumatorëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2016 ka rezultuar të jetë 25% më i ulët se viti paraprak. Numri i konsumatorëve të telefonisë mobile për periudhën e vitit 2016 është 12.7% më e lartë se viti paraprak. Numri i konsumatorëve të shërbimeve të internetit është 12.9% më i ulët se viti paraprak.

Performanca Financiare

Tabela 12: Performanca Vjetore Financiare – Telekom i Kosovës ShA

Indikatorët Financiarë (000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	84,830	92,788	76,000
Shpenzimet	72,119	(69,222)	(107,311)
<i>Zhvlerësimi dhe Amortizimi</i>	<i>(20,833)</i>	<i>(23,075)</i>	<i>(23,057)</i>
<i>Borxhet e këqija</i>	<i>0</i>	<i>(769)</i>	<i>0</i>
APTIZHA	12,929	23,566	(8,254)
Të ardhurat neto	(7,904)	(278)	(31,311)
Paraja në fund të vitit	4,589	2,481	685
Mjetet themelore	106,103	102,180	93,517

Performanca financiare e Telekomit të Kosovës ShA reflekton performancën operative ku përkundër planeve, realizimet në fund të vitit kanë qenë të ndryshme, si në vijim:

- Të hyrat e planifikuara për vitin 2016 janë për 16% më të larta se të hyrat e realizuara, ndërsa të hyrat e realizuara në vitin 2016 janë për 10% më të ulta në krahasim me vitin paraprak;
- Shpenzimet e planifikuara janë më të ulta për 35% në krahasim me realizimin e 2016;
- Shpenzimet e realizuara për vitin 2016 janë për 13% më të larta se sa shpenzimet e realizuara në vitin paraprak.

Si rrjedhim i një performance të tillë, Telekom i Kosovës ShA ka përfunduar me një pozicion financiar si në Tabelën në vijim:

Tabela 13: Të ardhurat dhe pozita financiare - Telekom i Kosovës ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	84,830	76,000	Pasuritë	136,418	124,062
Të hyrat e shitjes	84,488	75,678	Mjetet themelore	106,103	93,517
Të hyra tjera	342	322	Ekuiteti	105,862	74,551
Shpenzimet	(92,952)	(107,311)	Detyrimet	30,556	49,511
Zhvlerësimi	(20,833)	(23,057)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(36,927)	(26,826)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(46,521)	(22,066)	Kthimi në pasuri	-5.79%	-25.2%
Të dala tjera	(1,329)	(35,362)	Kthimi në ekuitet	-7.47%	-41.9%
APTIZHA	12,711	(8,254)	Kontributi nga aksionari ('000)	-	-
Të ardhurat neto	(7,904)	(31,311)	Subvencion	-	-
Nr. i punëtorëve	2,293	2,274	Projekte Kapitale	-	-


Telekom i Kosovës ShA vitin 2016 e ka përfunduar me rezultat negativ financiar me rreth (31,311,000).

Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, Telekom i Kosovës ShA ka shënuar një rritje prej 13% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet për paga kanë shënuar një rënie në 27% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e Telekomit të Kosovës ShA gjatë vitit 2016 janë tkurrur për 9% në krahasim me vitin paraprak, ekuiteti është tkurrur zvogëluar për 29.5% dhe detyrimet janë rritur për 38%.

Ne aspekt të sfidave dhe rreziqeve për TK mund të themi që viti 2016 është përmbyllur me vendimin nga Tribunali Ndërkombëtar tek Arbitrazhit që TK t'i paguajë 26.1 milionë euro gjobë (30 milion duke përfshirë interesin) e kompanisë Devolli e cila është pronare e Z-Mobile. Po ashtu, obligohet që t'ia jap 100 mijë numra shtesë si dhe shërbimet 3G dhe 4G.

Grafikoni 3: Tendenca e Pozicioneve Kyçe Financiare - TK ShA



Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Korporata Energjetike e Kosovës ShA
Nr. i Biznesit 70325399	Nr.Fiskal 6002622597
Kryeshefi Ekzekutiv:	Arben Gjukaj
Auditori i Jashtëm:	BDO Kosova LLC

Përbërja e Bordit	Nga 23 Tetor 2013
Kryesues Bordi	Berat Rukiqi
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Burim Leci
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Pranvera Dobruna
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Ranko Makic
Anëtar Bordi	Enver Muli
Anëtar Bordi	Haki Mjeku

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet e tjera	Bonuset ⁷	Gjithsej
76,261.21	5,999.95	-	35,038.92	117,300.08

Veprimtaria

Korporata Energjetike e Kosovës ShA (KEK) është korporatizuar në fund të vitit 2015. KEK-u operon me dy mihje sipërfaqësore (mihja e Mirashit dhe mihja e Bardhit), dhe dy Termocentrale (“Kosova A” dhe “Kosova B”). Veprimtaria parësore e KEK-ut është prodhimi i energjisë dhe shitja e energjisë në rrjetin e shpërndarjes që në Republikën e Kosovës në vitin 2015 është në pronësi dhe kontroll të një kompanie me aksione në pronësi të sektorit privat.

KEK-u për kryerjen e veprimtarisë së saj ka një strukturë të përbërë nga:

- Divizioni i Mihjes (prodhimi i qymyrit);
- Divizioni i Gjenerimit (prodhimi i energjisë elektrike).

Sa i përket tregut të energjisë në Kosovë, duke përfshirë tarifën e energjisë elektrike, ky treg rregullohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Republikës së Kosovës.

Misioni

Prodhimi i energjisë elektrike e cila duhet të jetë e bazuar në kosto. Ndërsa në anën tjetër edhe zbatimi i rregulloreve për siguri dhe shëndet dhe i standardeve mjedisore, duke tërhequr investimet me qëllim të mbajtjes së qëndrueshmërisë financiare dhe zhvillimit. Të gjitha këto gjithmonë në ruajtjen e aseteve të kompanisë përmes mirëmbajtjes së duhur dhe përkrahjes së vlerave thelbësore të kompanisë, si transparenca dhe sjellja etike.

⁷ Përfshinë dhe pagesën retroaktive të Komisioneve të Përkohshme.

Vizioni

Njësitë e KEK-ut, të cilat përfshijnë Minierat e Qymyrit dhe Gjenerimit: Termocentrali (“Kosova A” dhe Termocentrali “Kosova B”), të përfshijnë afarizmin komercialisht të zbatueshëm dhe të qëndrueshëm, të cilat menaxhohen dhe operohen në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare për ofrimin e shërbimeve të besueshme dhe korrektuese.

Performanca Operative

Tabela 14: Performanca Vjetore Operative - KEK ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Prodhimi i Qymyrit (në mijë tonë)	8,240	8,400	8,801
Prodhimi i Energjisë MWh (000)	5,361	5,537	5,601

Korporata Energjetike e Kosovës ShA sa i përket prodhimit të qymyrit në vitin 2016 ka realizuar 4.5% më shumë se plani, ndërsa në krahasim me vitin 2015, realizimi shënon rritje prej 6.3%.

Në anën tjetër realizimi i gjenerimit të energjisë elektrike është 1.2% më shumë se plani ndërsa në krahasim me vitin paraprak realizimi ka shënuar një rritje prej 4%.

Performanca Financiare

Tabela 15: Performanca Vjetore Financiare - KEK ShA

Treguesit Financiarë (000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	154,929	178,732	169,353
Shpenzimet	(146,885)	(139,446)	(158,355)
<i>Zhvlerësimi dhe Amortizimi</i>	(39,597)	-	(35,195)
<i>Borxhet e këqija</i>	(243)	-	(310)
<i>Shpenzimet/hyrat financiare</i>	(1,973)	-	(7,623)
<i>Tatimi</i>	(1,356)	-	(2,861)
APTIZHA	49,614	54,114	56,677
Të ardhurat neto	6,688	12,081	10,998
Paraja në fund të vitit	41,121	41,121	63,305
Mjetet themelore	331,338	329,128	305,765

Korporata Energjetike e Kosovës ShA (KEK) gjatë vitit 2016 ka shënuar një performancë me ndryshime ndërmjet planeve dhe realizimeve siç paraqitet në vijim:

- Të hyrat e realizuara në vitin 2016 janë 5.2% më të ulëta se planifikimi i vitit 2016, ndërsa realizimi i vitit 2016 është për 8.5% më i lartë se realizimi i vitit 2015;
- Shpenzimet e realizuara në vitin 2016 janë 11.9% më të larta se planifikimi i tyre për këtë vit. Ndërsa realizimi i shpenzimeve gjatë vitit 2016 është 7% më i lartë se realizimi i shpenzimeve gjatë 2015.

Si rezultat i një performance të tillë, KEK ShA ka përfunduar vitin 2016 me një pozitë financiare si në vijim:


Tabela 16: Të ardhurat dhe Pozita Financiare - KEK ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	154,929	169,353	Pasuritë	416,514	417,581
Të hyrat e shitjes	144,545	156,609	Mjetet themelore	331,338	305,765
Të hyrat tjera	10,384	12,744	Ekuiteti	90,850	101,885
Shpenzimet	(146,885)	(158,355)	Detyrimet	325,664	315,696
Zhvlerësimi	(39,597)	(35,195)	Kreditë	189,395	182,680
Shpenzimet për paga	(49,425)	(48,983)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(55,890)	(66,554)	Kthimi në pasuri	1.61%	2.6%
Të dala tjera	(1,973)	(7,623)	Kthimi në ekuitet	7.36%	10.8%
APTIZHA	49,614	56,677	Kontributi nga aksionari ('000)		-
Të ardhurat neto	6,688	10,998	Subvencion	-	-
Nr. i punëtorëve	4,619	4,144	Projekte Kapitale	-	-

KEK ShA vitin 2016 e ka përfunduar me një rezultat pozitiv financiar me një kthim në pasuri prej 2.6%, që edhe është kthimi më lartë se viti paraprak që kishte një kthim prej vetëm 1.6%. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KEK ShA ka shënuar një rritje prej 7% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet për paga kanë shënuar ulje prej 0.9% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e KEK ShA gjatë vitit 2016 janë rritur për 0.2%, ekuiteti është rritur për 10.8% ndërsa detyrimet janë zvogëluar për 3%.

Grafikoni 4: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KEK ShA



Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Hekurudhat e Kosovës – “TrainKos” ShA
Nr. i Biznesit 70773120	Nr.Fiskal 600705101
Kryeshefi Ekzekutiv:	Gelor Shala
Auditori i Jashtëm:	ETIKA

Përbërja e Bordit	Nga 16 Shtator 2015
Kryesues Bordi	Sadik Kryeziu
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Labinot Halilaj
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Naim Gashi
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Mustafa Mustafa
Anëtar Bordi	Bujar Hasimi
Anëtar Bordi	Bastri Sallahu

Kompensimet dhe Bonuset e Bordit				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsejë
34,050	4,635	0	0	38,685

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Kompania Hekurudhat e Kosovës – “TrainKos” ShA ka filluar së vepruari si kompani e re më 1 shtator 2011 pas një procesi të ndarjes, ndërmjet infrastrukturës hekurudhore dhe operatorëve të mjeteve lëvizëse. Si rezultat, veprimtaria kryesore e “TrainKos” ShA është transporti hekurudhor i udhëtarëve dhe mallrave. Zhvillimi i biznesit për ofrimin e këtyre shërbimeve është paraparë në Planin e Rishikuar të Biznesit për vitin 2016 që është diskutuar dhe aprovuar bashkë me planifikimin buxhetor. Zhvillimi strategjik i biznesit është mbështetur në deklaratën e precizuar për misionin dhe vizionin e zhvillimit të biznesit të kompanisë për vitin 2016.

Misioni

Ofrimi i shërbimeve të transportit të mallrave konform standardeve ndërkombëtare, duke ofruar në vazhdimësi çmime konkurruese, siguri të lartë, cilësi dhe korrektësi ndaj klientëve.

Të jemi zgjidhje e parë në transportin e udhëtarëve, me komoditet, saktësi dhe besueshmëri për një udhëtim më të mirë.

Vizioni

HK – “TrainKos” ShA lider në transportin e mallrave dhe emër për saktësi dhe komoditet në transportin e udhëtarëve.

Performanca Operative

Tabela 17: Performanca Vjetore Operative – “TrainKos” ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Transporti i Mallrave (tonë)	742,439	798,427	244,648
Numri i Udhëtarëve	268,372	310,000	278,190

Hekurudhat e Kosovës – “TrainKos” ShA në vitin 2016 kanë realizuar 30% të transportit të mallrave të planifikuar. Një ulje e tillë e realizimit të transportit të mallrave i atribuon ulja e kërkesave të tregut e në veçanti rol kyç në këtë drejtim ka pasur moslidhja e kontratës gjatë gjithë vitit me NeëCo Ferronikeli, e cila gjë ka ndikuar tej mase në uljen e sasisë së transportuar për 67% në krahasim me vitin 2015.

Sa i përket transportit të udhëtarëve, “TrainKos” ShA në vitin 2016 ka arritur të realizoj 3.6% më shumë udhëtarë në krahasim me vitin paraprak, kurse në realizimin e Planit të Biznesit ka një devijim prej 10% se sa është planifikuar për vitin 2016.

Performanca Financiare

Tabela 18: Performanca Vjetore Financiare – “TrainKos” ShA

Treguesit Financiarë (000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	5,097	4,558	3,151
Nga të cilat: të hyra të jashtëz.	745		
Shpenzimet	(4,997)	(3,504)	(3,353)
<i>Zhvlërimi dhe Amortizimi</i>	(972)	1,054	(202)
<i>Borxhet e këqija</i>	-	(985)	(985)
APTIZHA	1,072	-	0
Të ardhurat neto	100	69	(1,187)
Paraja në fund të vitit	1,826	-	51
Mjetet themelore	5,820	-	5,908

“TrainKos” ShA gjatë vitit 2016 ka shënuar me ndryshime ndërmjet planeve dhe realizimeve siç paraqitet në vijim:

- Të hyrat e përgjithshme për vitin 2016 janë realizuar për 31% më pak se sa që është planifikuar, kurse krahasuar me të hyrat e realizuara me vitin paraprak ajo është për 38% më e ulët.
- Shpenzimet e planifikuara për vitin 2016 janë 3% më të larta se realizimi i vitit 2016, ndërsa në krahasim me vitin paraprak është për 10% më i ulët.

Si rezultat i një performance të tillë, “TrainKos” ShA ka përfunduar vitin 2016 me një pozitë financiare si në vijim:

Tabela 19: Të ardhurat dhe Pozita Financiare – “TrainKos” ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	5,097	3,151	Pasuritë	10,485	9,279
Të hyrat e shitjes	3,422	2,211	Mjetet themelore	5,820	5,927
Të hyra tjera	1,675	1,584	Ekuiteti	5,844	5,003
Shpenzimet	(4,997)	(4,338)	Detyrimet	4,641	5,056
Zhvlerësimi	(972)	(985)	Kreditë	4,142	4,196
Shpenzimet për paga	(1,773)	(1,796)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(2,251)		Kthimi në pasuri	0,95%	-12.79
APTIZHA	1,072	(202)	Kthimi në ekuitet	1,71%	-23.73
Të ardhurat neto	100	(1,187)	Kontributi nga aksionari ('000)	1,590	1,350
Nr. i punëtoreve	231	237	Subvencion	500	500
			Projekte Kapitale	1,090	800


“TrainKos” ShA vitin 2016 e ka përfunduar me një bilanc financiar negativ krahasuar me vitin paraprak. Si rrjedhim, “TrainKos” ShA ka rezultuar me kthim në pasuri prej -12.8 % që është negativ krahasuar me vitin 2015.

Në lidhje me Të Hyrat e Shitjes, “TrainKos” ShA në vitin 2016 ka realizuar 2,21 mil. euro Të Hyra nga Shitja apo 35 % më pak se në vitin paraprak.

Kurse sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, “TrainKos” ShA ka shënuar një ulje prej 10% krahasim me vitin 2015. Ndërsa shpenzimet për paga kanë shënuar rritje prej 1.27% krahasuar me vitin paraprak. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave në shpenzimet totale arrin në 40.2%, kurse në Të Hyra të Shitjes prej 48.7%.

Si rrjedhim, mjetet themelore të “TrainKos” ShA gjatë vitit 2016 janë rritur për 1,8%, ekuiteti është zvogluar për 14% ndërsa detyrimet janë rritur për 8% krahasuar me vitin paraprak.

Grafikoni 5: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare – “TrainKos” ShA



Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “InfraKos” ShA
Nr. i Biznesit 70325327	Nr.Fiskal 600281399
Kryeshefi Ekzekutiv:	Agron Thaqi
Auditori i Jashtëm:	ETIKA

Përbërja e Bordit	Nga 9 Shtator 2015
Kryesues Bordi	Enver Aruqaj
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Fëllënza Xhelili
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Nijazi Selmani
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Nexhat Dedia
Anëtar Bordi	Milazim Bytyçi
Anëtar Bordi	Milos Dimic

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
34,500	4,630	0	0	39,130

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “InfraKos” ShA është një kompani e korporatizuar dhe regjistruar si Shoqëri Aksionare që si veprimtari kryesore ka menaxhimin e rrjetit hekurudhor të Kosovës. Ky rrjet shërben për bartjen e një numri të madh të udhëtarëve dhe mallrave në mënyrë të efektshme dhe të sigurtë falë angazhimeve të viteve të kaluara. Kjo kompani përveç ofrimit të shërbimeve të menaxhimit të rrjetit hekurudhor, ofron edhe shërbime të qiradhënies dhe dhënies në shfrytëzim të patundshmërive për klientët e saj.

Misioni

Duke ofruar një rrjet hekurudhor konkurrues, të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë, si dhe duke i plotësuar kërkesat e sigurisë të ambientit dhe ato ekonomike.

Vizioni

Të jemi prijës në ofrimin e linjave hekurudhore dhe shërbimeve tjera të infrastrukturës, për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese. Të jemi ofrues tërheqës dhe më të efektshëm të rrjetit hekurudhor në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Performanca Financiare

Tabela 20: Performanca Vjetore Financiare – “InfraKos” ShA

Indikatorët Financiarë (000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	3,764	3,600	2,931
Shpenzimet	(4,027)	(3,201)	(3,947)
Zhvlerësimi Amortizimi	dhe (1,161)	-	1,212
Borxhet e këqija	-	-	-
APTIZHA	899	1,301	196
Të ardhurat neto	(264)	-	(1,016)
Paraja në fund të vitit	195	-	68
Mjetet themelore	20,661	-	20,275

“InfraKos” ShA gjatë vitit 2016 ka shënuar me ndryshime ndërmjet planeve dhe realizimeve siç paraqitet në vijim:

- Të hyrat e planifikuara për vitin 2016 janë 18.58% më të ulëta se realizimi i vitit 2016, ndërsa realizimi i vitit 2016 është për 22.13% më i ulët krahasuar me vitin paraprak;
- Shpenzimet e planifikuara për vitin 2016 janë 23.31% më të larta se realizimi për këtë vit (duke mos përfshirë në planifikim zhvlerësimin dhe amortizimin), ndërsa realizimi i shpenzimeve në vitin 2016 është për 2.2 % më i ulët se plani se në vitin paraprak.

Si rezultat i një performance të tillë, “InfraKos” ShA ka përfunduar vitin 2015 me një pozitë financiare si në vijim:

Tabela 21: Të ardhurat dhe pozita financiare – “InfraKos” ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	3,764	2,931	Pasuritë	23,818	23,381
Të hyrat e shitjes	1,400	1,399	Mjetet themelore	20,661	20,275
Të hyra tjera	2,364	1,532	Ekuiteti	14,538	13,646
Shpenzimet	(4,028)	(3,947)	Detyrimet	9,280	9,725
Zhvlerësimi	(1,162)	(1,212)	Kreditë	-	
Shpenzimet për paga	(2,176)	(2,154)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(690)	(581)	Kthimi në pasuri	-1,11	-4.35
Të dala tjera	-	-	Kthimi në ekuitet	-1,82	-7.45
APTIZHA	898	196	Kontributi nga aksionari ('000)	1,673	1,571
Të ardhurat neto	(264)	(1,016)	Subvencion	600	700
Nr. i punëtorëve	317	324	Projekte Kapitale	1,037	819

“InfraKos” ShA vitin 2016 e ka përfunduar me një rezultat më të thelluar negativ financiar prej 284% më të ulët krahasuar me vitin 2015. Kjo gjë reflekton edhe në uljen e APTIZHA për 78.1% krahasuar me vitin paraprak.


Edhe kthimi në pasuri prej -4.4% paraqet kthim më të ulët të pasurisë së kësaj kompanie në krahasim me vitin 2015.

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “InfraKos” ShA gjatë vitit 2016 ka pasur Të Hyra nga Shitja 1,4 milion euro, e cila shumë rezulton e njëjtë me vitin paraprak.

Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, “InfraKos” ka shënuar një ulje prej 2% në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet për paga kanë shënuar një ulje të lehtë për 1.1 %. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave në shpenzimet totale për vitin 2016 është 54.5%, kurse shpenzimet e pagave tejkalojnë Të Hyrat e Shitjes prej 53%.

Si rrjedhim, pasuritë e “InfraKos” ShA gjatë vitit 2016 janë tkurrur për 1.8%, gjithashtu edhe ekuiteti është tkurrur për 6%, ndërsa detyrimet janë rritur për 4.7% krahasuar me vitin 2015.

Grafikoni 6: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare – “InfraKos” ShA



Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Aeroporti i Gjakovës SHA
Nr. i Biznesit 71213404	Nr.Fiskal 601541057
Kryeshefi Ekzekutiv:	Vlora Gojani
Auditori i Jashtëm:	Nimon Zeneli- Auditor ligjor i lincencuar

Përbërja e Bordit	16 Shtator 2015
Kryesues Bordi	Brikenda Kryeziu
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Nora Gola
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Naser Canolli
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Nuri Bahtijari
Anëtar Bordi	Zenun Shala
Anëtar Bordi	Brikenda Kryeziu

Kompensimet dhe Bonuset ⁸				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
35,400	5,800	-	-	41,200

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Aeroporti i Gjakovës është ndërtuar që pas Luftës së Dytë Botërore për nevoja të agrokulturës, kurse në vitet e 90-ta ka pushuar së funksionuari.

Menjëherë pas luftës së fundit në Kosovë, Aeroporti i Gjakovës i është dhënë në shfrytëzim KFOR-it italian, të cilët kanë investuar në ndërtimin dhe funksionalizimin e Aeroportit të Gjakovës. Kurse me datë 18 dhjetor 2013 Aeroporti i Gjakovës i është dorëzuar Qeverisë së Kosovës si donacion nga Forcat Ajrore Italiane. Me datë ... Qeveria e Republikës së Kosovës ka themeluar Ndërmarrjen Publike Aeroporti i Gjakovës, me ç'rast pas emërimit të Bordit të Drejtorëve me datë 09.09.2015, kjo Ndërmarrje Publike ushtron veprimtarinë e saj si Shoqëri Aksionare.

Aeroporti i Gjakovës në fazën aktuale synon që përmes studimit të fizibilitetit të funksionalizoj dhe të shfrytëzoj resurset e trashëguara, të determinoj fushëveprimtarinë e vet, të bashkëpunoj me institucionet qeveritare, dhe ato të cilat ofrojnë shërbime aeronautike apo përmes PPP.

⁸ Kompensimet për BD dhe KA janë për periudhën tetor 2015 – dhjetor 2016, meqenëse pagesat janë kryer brenda vitit fiskal 2016.

Misioni

Të operojë, mirëmban dhe ruan kualitet të lartë të shërbimeve aeronautike dhe të sigurojë qëndrueshmeri financiare dhe shërbime efikase, efijente të aviacionit.

Vizioni

Aeroporti i sigurtë me operime të kualitetit të lartë dhe me qëndrueshmëri financiare që me sukses dhe efektivitet të promovojë dhe t'u shërbejë nevojave ekonomike dhe sociale të vendit.

Performanca Financiare

Performanca e Aeroportit të Gjakovës nuk mund të krahasohet me vitin paraprak, pasi që kjo Ndërmarrje Publike ka arritur të regjistrohet në ARBK pas emërimit të Bordit të Drejtorëve nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës në fund të vitit 2015.

Aeroporti i Gjakovës ka përfunduar vitin 2016 me një pozitë financiare si në vijim:

Tabela 22:Të ardhurat dhe pozita financiare – Aeroporti i Gjakovës ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2016	Pozicioni financiar ('000)	2016
Të hyrat	706	Pasuritë	9,385
Të hyrat e shitjes	0	Mjetet themelore	8886
Të hyra tjera	0	Ekuiteti	25
Shpenzimet	706	Detyrimet	56
Zhvlerësimi	504	Kreditë	
Shpenzimet për paga	118	Raportet Kyçe	
Shpenzimet tjera operative	84	Kthimi në pasuri	0
Të dala tjera	-	Kthimi në ekuitet	0
APTIZHA	504	Kontributi nga aksionari ('000)	706
Të ardhurat neto	-	Subvencion	706
Nr. i punëtoreve	10	Projekte Kapitale	-

Ndërmarrja Publike Qendrore Aeroporti i Gjakovës ende nuk ka krijuar të hyra nga veprimtaria e saj. Si peng e këtij fakti kjo ndërmarrje ka arritur që përmes të hyrave nga subvencioneve të pranuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mbuloj shpenzimet operative të krijuara gjatë vitit 2016.

Të dhënat e korporatës	
Emri i kompanisë:	Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” ShA
Nr. i Biznesit 70465157	Nr.Fiskal 600280482
Kryeshefi Ekzekutiv:	Januz Kabashi
Auditori i Jashtëm:	NSh “Universum Audit”

Përbërja e Bordit	16 Shtator 2015
Kryesues Bordi	Fatos Sahiti
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Imer Hamiti
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Albiona Maloku
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Bashkim Shabani
Anëtar Bordi	Mërgim Lushtaku

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
28,837	4,620	0	14,940	48,397

Veprimtaria e Ndërmarrjes

“Ibër Lepenc” ShA si ndërmarrje hidroekonomike merret me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit shumëfunktional për furnizim me ujë dhe gjenerim të energjisë elektrike. Pasuritë kryesore të ndërmarrjes janë:

- Diga në liqenin akumulues të Ujëmanit;
- Hidrocentrali “Ujman”;
- Kanali kryesor “Pridvoricë – Obiliq” me gjatë rreth 50km që mundëson furnizimin e industrinë me ujë të papërpunuar, më saktësisht:
 - Termocentralin “Kosova A” dhe “Kosova B”;
 - Ferronikelin;
 - Ujësjellësin Rajonal në Mitrovicë, dhe
 - Ujësjellësin Rajonal në Prishtinë;
- Rrjeti nëntokësor për furnizimin e bujqësisë me ujë për ujitje.

Misioni

Ofrimi i shërbimeve sa më kualitative për konsumatorët dhe rritja afatgjatë e vlerës së pasurive të ndërmarrjes në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare të qeverisjes korporative.

Vizioni

Duke ruajtur dhe mirëmbajtur asetet ekzistuese dhe duke shtuar investimet kapitale në mënyrë të vazhdueshme, që në të ardhmen të kryej zgjerimin e shërbimeve për konsumatorët.

Performanca Operative

Tabela 23: Performanca Vjetore Operative – “Ibër Lepenc” ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Ujë i furnizuar (m3)	38,753	39,756	39,413
Ujitja e tokave ujqësore (ha)	1,590	1,710	1,372
Energjia e prodhuar dhe shitur (MWh)	101,537	88,000	96,869

Bazuar në të dhënat e mbledhura, gjatë periudhës janar – dhjetor 2016 u prodhuan 96,869 Mwh energji elektrike, sasi kjo që tejkaloi prodhimin e planifikuar për 8,869 Mwh. Ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjenerimi i energjisë elektrike ishte më i ulët për 4,668 Mwh që nëse shprehet në përqindje i bie 4,6% më pak.

Gjenerimi i energjisë elektrike varet prej mundësive teknike, gjegjësisht prej nivelit të ujit në akumulim si dhe prej kërkesave të KEDS-it.

Pasi që plani është përpiluar sipas kërkesave të shfrytëzuesve, në Tabelë shihet se realizimi i distribuimit të ujit është më i ulët për 0,9% në krahasim me sasinë e planifikuar, dhe 1,7% më i madh në krahasim me vitin e kaluar. Vlen të theksohet se furnizimi me ujë industrial është kryesisht i ndikuar nga kërkesat e klientëve për sasinë e ujit që ju nevojitet.

Edhe ujitja varet kryesisht nga interesimi i fermerëve për ujitje të tokave bujqësore. Gjatë vitit 2016 shihet që realizimi është për 218 ha ma i ulët në krahasim me vitin 2015 apo për 338 ha më pak se plani. Rënia e hektarëve të ujitur është si rezultat i rënies së kërkesës nga ana e fermerëve për kultivimin e kulturave bujqësore.

Performanca Financiare

Tabela 24: Performanca Vjetore Financiare – “Ibër Lepenc” ShA

Treguesit Financiar (000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	4,154	4,064	3,882
Shpenzimet	3,717	(3,911)	(3,625)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	(4,639)	(4,679)	(4,652)
Borxhet e këqija	/	/	/
APTIZHA	437	153	257
Të ardhurat neto	(4,202)	(4,526)	(4,395)
Paraja në fund të vitit	626	/	206
Mjetet themelore	126,850	/	122,288

Në bazë të performancës së lartëpërmendur, Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” në vitin 2016 ka gjeneruar Të Hyra nga Shitja në vlerë prej 3,882 mijë euro, apo 272 mijë euro më pak se në vitin 2015.

Edhe në këtë vit, të hyrat nga energjia elektrike paraqesin burimin më të madh të të hyrave të përgjithshme me një pjesëmarrje prej 61% apo më e ultë se sa që është planifikuar në Planin e Biznesit. Ndërsa pjesëmarrja e ujit në totalin e Të Hyrave të Shitjes është 34,2% apo më e ulët se sa që është planifikuar, dhe situatë e njëjtë është edhe me të hyrat nga ujitja që përbëjnë 4% të të hyrave totale e që gjithashtu janë më të ulëta se sa të hyrat e planifikuara në Plan të Biznesit.

Ndërsa shpenzimet operative për vitin 2016 janë përafërsisht të njëjta me ato të vitit 2015 me një rënie të lehtë krahasuar me vitin e kaluar,

Kjo kompani në vitin 2016 ka pas një rënie të vlerës së asetëve në krahasim me vitin 2015 për 4.562 milion euro. Kjo rënie e vlerës së asetëve ka ardhë si rezultat i zhvlerësimit (amortizimit) të mjeteve në vlerë prej: 4,652 milion euro. Si rezultat i rënjes së vlerës së asetëve, dhe shpenzimeve të mëdha të zhvlerësimit, kjo kompani përfundimisht del në humbje financiare.


Tabela 25: Të ardhurat dhe pozita financiare – “Ibër Lepenc” ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	4,154	3,882	Pasuritë	129,985	125,252
Të hyrat e shitjes	4,125	3,853	Mjetet themelore	126,851	122,288
Të hyra tjera	29	29	Ekuiteti	128,757	124,367
Shpenzimet	(8,356)	(8,277)	Detyrimet	1,228	885
Zhvlerësimi	(4,639)	(4,652)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(3,007)	(3,003)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(710)	(622)	Kthimi në pasuri	-3,23%	-3,51%
Të dala tjera	0	0	Kthimi në ekuitet	-3,26%	-3,53%
APTIZHA	437	257	Kontributi nga aksionari ('000)		-
Të ardhurat neto	(4,202)	(4,395)	Subvencion	-	-
Nr. i punëtoreve	270	276	Projekte Kapitale	-	-

Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” ShA vitin 2016 e ka përfunduar me një rezultat financiar negativ. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, NHE “Ibër Lepenc” ShA ka shënuar ulje për 0,95%, ndërsa shpenzimet për paga kanë qenë pothuajse të njëjta me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e NHE “Ibër Lepenc” ShA gjatë vitit 2016 janë tkurrur për 3,7%, gjithashtu edhe ekuiteti është tkurrur për 3,4%, ndërsa detyrimet kanë pësuar zbritje për 28% në krahasim me vitin paraprak.

Grafikoni 7: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - NHE "Ibër Lepenc" ShA



Të dhënat e korporatës			
Emri i Kompanisë:	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë ShA		
Nr. i Biznesit	70324870	Nr.Fiskal	600215570
Kryeshefi Ekzekutiv:	Abdullah Haxhiu		
Auditori i Jashtëm:	Zyra Kombëtare e Auditimit		

Përbërja e Bordit	23 Shtator 2015
Kryesues Bordi	Lundrim Camaj
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Hafiz Krasniqi
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Xhavit Hasani
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Gazmend Bytyçi
Anëtar Bordi	Goran Lazic
Anëtar Bordi	Nexhat Berisha

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet e tjera	Bonuset	Gjithsej
26,154	3,357	0	11,787	42,298

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK ShA) është kompania e vetme, e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe plotësisht e regjistruar si Shoqëri Aksionare, sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 03/ L-123.

Si e tillë dhe duke marrë parasysh natyrën e shërbimeve që ofron, ka një rol thelbësor në parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe keqpërdorimin e mundshëm të këtij shërbimi. Gjithashtu, ka rol edhe në stimulimin e efikasitetit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore të këtyre shërbimeve. Këtë rol KMDK ShA e ushtron në kuadër të legjislacionit dhe mekanizmave rregullator që mbulojnë këtë fushë.

Shërbimet e KMDK ShA shtrihen në nivel kombëtar, ndërsa posedon deponi në komunat si në vijim:

- Prishtinë (Deponi Sanitare);
- Podujevë (Deponi Sanitare);
- Prizren (Deponi Sanitare);
- Gjilan (Deponi Sanitare);
- Ferizaj (Stacion për transferim).

KMDK ballafaqohet me probleme në funksionalitet, nga fakti se nuk ka mundësi të trajtimit të mbeturinave sipas standardeve. Kjo vjen si mungesë e potencialeve financiare për investime në makineri të rendë, pasi operatorët për grumbullimin e mbeturinave që janë kompani regjionale të

mbeturinave me pronësi 100% të komunave, kanë obligime financiare për deponimin e mbeturinave në vlerë prej mbi 3 milionë euro të cilat janë në finalizim të përmbylljes përmes rrugës gjyqësore edhe Lgjit mbi Faljen e Borxhit.

Misioni

Deponimin e mbeturinave të ngurta komunale në deponitë sanitare regjionale në mënyrë sa më efektive, në pajtim me standardet gjenerale dhe praktikat e mira evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve në deponimin e mbeturinave të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të arsyeshme për grumbulluesit e mbeturinave në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Vizioni

Shërbime cilësore, të sigurta, dhe efikente në deponimin e mbeturinave sipas standardeve mjedisore dhe ruajtjes së ambientit për qytetarët e Kosovës.

Rritja e vlerës së pasurive përmes investimeve kapitale dhe qëndrueshmërisë financiare të kompanisë, trajtimi i mbeturinave përmes ndarjes dhe selektimit, riciklimit, çka do të ndikojë në ruajtjen e ambientit dhe jetëgjatësinë e deponive.

Performanca Operative

Tabela 26: Performanca Vjetore Operative - KMDK ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Deponimi i mbeturinave (tonë)	246,662	223,056	257,217
Shkalla e Inkasimit %	109	100	118

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës ShA gjatë vitit 2016 ka realizuar 257,217 tonë mbeturina, apo 4.3% më shumë se realizimi i vitit 2015 dhe 15.3% më shumë se plani 2016. Sa i përket inkasimit shihet se plani për vitin 2016 ishte 100% ndërsa realizimi 118%.

Performanca Financiare

Tabela 27: Performanca Vjetore Financiare – KMDK ShA

Treguesit Financiarë (000€)	Realizimi 2015	Plani i Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	1521	1,859	1,851
Shpenzimet	(1,340)	(1,396)	(1,487)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	(840)	(889)	(874)
Borxhet e këqija	-	-	-
APTIZHA	180	463	371
Të ardhurat (humbjet) neto	(659)	(426)	(508)
Paraja në fund të vitit	14	-	55
Mjetet themelore	4799	-	4482

Nëse shikohet performanca financiare e vitit 2016 për secilin pozicion atëherë mund të shihet se ka pasur variacione ndërmjet planeve dhe realizimit. Siç mund të shihet edhe në Tabelë, KMDK SHA ka shënuar devijimet financiare si në vijim:

- Të hyrat e realizuara janë për 0.6% më të ulëta se sa plani;
- Shpenzimet janë 6.6% më të ulëta se sa plani;
- Të Ardhurat Para Tatimit Interesit Zhvlerësimit dhe Amortizimit janë për 20.1% më të ulëta se sa plani; dhe
- Humbjet neto janë 16.1% më të ulëta se sa plani.

Një performancë e tillë, KMDK ShA në fund të vitit 2016 ka shënuar një pozicion financiar të paraqitur në Tabelën 11 në vijim:

Tabela 28: Të ardhurat dhe pozita financiare - KMDK ShA


Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	1,521	1,851	Pasuritë	6,385	5,488
Të hyrat e shitjes	1,350	1,560	Mjetet themelore	3,299	2,609
Të hyra tjera	170	292	Ekuiteti	4,800	4,483
Shpenzimet	(2,180)	(2,359)	Detyrimet	1,585	1,005
Zhvlerësimi	(840)	(872)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(585)	(601)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(755)	(886)	Kthimi në pasuri	-10.33%	-9.26%
Të dala tjera	-	-	Kthimi në ekuitet	-13.74%	-11.34%
APTIZHA	180	371	Kontributi nga aksionari ('000)	59	
Të ardhurat neto	(659)	(508)	Subvencion	59	-
Nr. i punëtorëve	73	77	Projekte Kapitale	-	-

Nga kjo Tabelë shihet se KMDK ShA ka përfunduar vitin 2016 me një rezultat negativ financiar, ku edhe përkundër rritjes të Të Hyrave të Shitjes për 13%, shënon një kthim në pasuri prej -9.3% që është një trend negativ por krahasuar me vitin paraprak ka një rritje të lehtë. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KMDK ShA ka shënuar një rritje prej 7.5% ndërsa shpenzimet për paga një rritje prej 2.6% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e KMDK ShA gjatë vitit 2016 janë tkurrur për 14%, ekuiteti gjithashtu është tkurrur për 6.6%, ndërsa edhe detyrimet kanë shënuar një rënie prej 36.5% në krahasim me vitin paraprak.

Sa i përket Të Hyrave të Shitjes, KMDK ShA në vitin 2016 ka regjistruar 1,85 mil. euro Të Hyra nga Shitja apo rreth 17.8% më shumë se në vitin paraprak. Një rritje e tillë e Të Hyrave të Shitjes është kryesisht si rezultat i rritjes së sasisë së mbeturinave dhe arkëtimit të borxheve nga e kaluara.

Grafikoni 8: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KMDK ShA



Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina" ShA
Nr. i Biznesit 70433736	Nr.Fiskal 600268016
Kryeshefi Ekzekutiv:	Ilir Avdullahu, ud
Auditori i Jashtëm:	Audit AK

Përbërja e Bordit	Nga 30 Tetor 2015
Kryesues Bordi	Amir Gashi
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Ardian Syla
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Driton Gërxhaliu
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Ilir Rexhepi
Anëtar Bordi	Shuajb Mehmeti
Anëtar Bordi	Hasan Zeqiri

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
38,915	4,620	0	20,443	63,978

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina", është ndërmarrja më e madhe e ujit të pijshëm në Kosovë ku shërbimet e veta i ofron në pjesën qendrore të Kosovës, duke i përfshirë këto komuna: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Shtime, Lipjan, Drenas, Podujevë, Graçanicë dhe Vushtrri (Fshatin Prilluzhë dhe Stanovc).

Numri i popullatës së shërbyer në zonën që operon KRU "Prishtina" ShA vlerësohet mbi 450.000 banorë. Kapaciteti momental prodhues (i mundshëm nën supozimin e ekzistimit të rezervave të mjaftueshme të burimeve të ujit në liqenet akumuluese) sillet rreth $Q=1400$ l/s ose minimalisht 42.000.000 m³ ndërsa maksimalisht deri në 45.000.000 m³ në vit.

KRU "Prishtina" ShA i posedon dy fabrika për trajtimin e ujit të alokuara në Albanik (Shajkoc të Podujevës) dhe në Badovc. Në këto fabrika uji fillestar merret nga liqenet artificiale akumuluese; Batllavë dhe Badovc.

Ndërsa në fazën e implementimit është edhe Fabrika e ujit në Shkabaj, projekt ky që është në bashkëfinancim me KFW, KE, Qeverinë e Kosovës dhe komunën e Prishtinës.

KUR "Prishtina" ShA i posedon tri fabrika për trajtimin e ujit të alokuara në Albanik(Shajkoc të Podujevës) në Badovc dhe në Shkabaj. Në këto fabrika uji fillestar merret nga liqenet artificiale akumuluese; Batllavë, Badovc dhe Ujëman (Gazivodë).

Misioni

Konsumatori është në qendër të vëmendjes, që do të ketë trajtim dhe qasje të barabartë në shërbim: Pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor. Duke përbushur këtë mision do të bëhet i mundur sigurimi i vetëqëndrueshmërisë me qëllimin e fundit që të sigurojë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dhe një kompani publike, të qëndrueshme financiarisht dhe të gatshme të ballafaqohet me sfidat.

Vizioni

Krijimi i shërbimeve sa më cilësore dhe të pandërprera të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit, me çmime sa më të favorshme dhe më ujë cilësor dhe të shëndetshëm për popullatën, si dhe rritjen e vlerës së aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.

Performanca Operative

Tabela 29: Performanca Vjetore Operative - KRU "Prishtina" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Prodhimi i ujit në (000)m ³	41,282	44,465	44,846
Faturimi i ujit (%)	49	53	47
Inkasimi i ujit (%)	76	82	90
Uji i pafaturuar (%)	51	47	53
Testet e dështuara të ujit (%)	0	/	/
Konsumatorëve me ujëmatës (%)	97	90	97
Numri i konsumatorëve	127,029	129,705	135,760

Nga të dhënat e paraqitura më lartë, shihet se prodhimi i ujit në vitin 2016 përveq që i ka tejkaluar parametrat e Plani të Biznesit, ka pas edhe një rritje prej 3,564 mijë m³ në krahasim me vitin 2015. Sa i përket pozicioneve Faturimi i ujit, Inkasimi i ujit dhe Uji i pafaturuar edhe pse caqet e projektuara në Plan të Biznesit nuk kanë qenë aq të larta, ekziston një variacion i konsiderueshëm i shifrave pozitive dhe negative të raportuara në fund të vitit. Në veçanti:

- Shkalla e faturimit nga 53% sa ishte planifikuar ka rënë në 47%, e që shënon rënie edhe në krahasim me vitin paraprak;
- Inkasimit nga 82% sa ishte planifikuar me Planin e Biznesit, është rritur në 90% e që shënon një rritje të lartë në krahasim me vitin e kaluar;
- Uji i pafaturuar është më i lartë se plani dhe më i lartë se në vitin 2015.

Performanca Financiare

Tabela 30: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Prishtina" ShA

Treguesit Financiarë ('000€)	Realizimi	Plani Biznesit	Realizimi
	2015	2016	2016
Të hyrat	14,566	15,413	15,149
Shpenzimet	(9,048)	(9,810)	(8,793)
Zhvlersimi dhe Amortizimi	(3,839)	(3,057)	(3,860)
Borxhet e këqija	(1,214)	(2,649)	(1,648)
APTIZHA	5,518	5,603	6,356
Të ardhurat (humbjet) neto	465	(103)	846
Paraja në fund të vitit	1,904	/	7,569
Mjetet themelore	60,551	/	100,953

Sa i përket të hyrave, Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina" ShA ka regjistruar 15.149 mijë euro apo 3.9% më shumë se në vitin paraprak. Një rritje e tillë ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve të rinj, dhe nga pagesat e borgjeve të konsumatorëve pas vitit 2008 (Ligji mbi Faljen e Borgjeve).

KRU "Prishtina" ShA ka shënuar disa ndryshime ndërmjet planeve dhe realizimeve të paraqitura si në vijim:

- Të hyrat e realizuara janë 1.7% më të ulëta se plani;
- Shpenzimet janë 10.4 % më ulëta se sa plani;
- Zhvlerësimi dhe Amortizimi janë 20.8 % më të larta se sa Plani i Biznesit 2016.

Si rezultat i një performance të tillë, KRU "Prishtina" ShA ka përfunduar vitin 2016 me një pozitë financiare si në vijim:


Tabela 31: Të ardhurat dhe pozita financiare - KRU "Prishtina" ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	14,566	15,149	Pasuritë	126,743	126,985
Të hyrat e shitjes	13,155	13,791	Mjetet themelore	60,551	100,953
Të hyra tjera	1,412	1,358	Ekuiteti	61,750	62,596
Shpenzimet	(14,101)	(14,303)	Detyrimet	64,994	64,389
Zhvlerësimi	(3,839)	(3,860)	Kreditë	24,889	-
Shpenzimet për paga	(4,829)	(4,975)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(5,353)	(5,356)	Kthimi në pasuri	0,37%	0,66%
Të dala tjera	(29)	(17)	Kthimi në ekuitet	0,75%	1,35%
APTIZHA	4,304	4,706	Kontributi nga aksionari ('000)		5,000
Të ardhurat neto	465	846	Subvencion	-	-
Nr. i punëtorëve	544	543	Projekte Kapitale	-	5,000

Nga kjo Tabelë shihet se KRU “Prishtina”, ka përfunduar vitin 2016 me rezultat financiar pozitiv. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KUR “Prishtina” ka shënuar një rritje prej 1.4%, ndërsa shpenzimet për paga janë rritur për 2.9% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e KRU “Prishtina” gjatë vitit 2016 janë rritur për 0.2%, ekuiteti është rritur për 1.4%, ndërsa detyrimet kanë shënuar rënie prej 0.9% në krahasim me vitin paraprak.

Grafikoni 9: Tendenca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU “Prishtina” ShA



Të dhënat e korporatës	
Emri i Kompanisë:	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” ShA
Nr. i Biznesit 70433740	Nr.Fiskal 600338033
Kryeshefi Ekzekutiv:	Sami Miftari
Auditori i Jashtëm:	NSh “Auditim & Kontabilitet” Prishtinë

Përbërja e Bordit	Nga 24 Tetor 2015
Kryesues Bordi	Blerim Gërxhaliu
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Mimoza Zeqiri
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Tefik Ujkani
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Halil Thaqi
Anëtar Bordi	Zukë Beqiri
Anëtar Bordi	Burhan Maxhuni

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
20,543	3,201	0	0	23,744

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Kompania Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica” ShA ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve të ujërave të zeza në pjesën veriore të Kosovës dhe mbulon këto komuna: Mitrovicën, Vushtrrinë, Skënderaj dhe Mitrovicën matanë lumit Ibër. Popullata e shërbyer me ujë të pijshëm dhe mirëmbajtjen e kanalizimeve vlerësohet të jetë rreth 390.000 banorë.

KRU “Mitrovica” operon me impiantin për trajtimin e ujit të pijshëm në periferi të qytetit, me kapacitet prodhues rreth 520 l/s, ndërsa nga viti 2011 ka në funksionim edhe impiantin e parë të kapacitetit të madh për trajtimin e ujërave të zeza në Skënderaj. Afro 39% nga uji i prodhuar distribuohet matanë Ibrit, pa u inkasuar nga shfrytëzuesit, por që Qeveria e Kosovës e mbulon me subvencione në % të mesatares së inkasuar në regjion.

Gjatë vitit 2014, është leshuar në fuksion Fabrika e re për trajtimin e ujit të pijshëm në Shipol me një kapacitet prej 700 l/s, donacion nga Bashkimi Evropian, me të cilin do të mund të plotësohen nevojat e konsumatorëve me 24 orë ujë në ditë. Ndërsa në Vushtri është ndertuar edhe Fabrika për trajtimin e ujit të pijshëm me kapacitet prej 350 l/s investim nga Qeveria e Kosovës.

Misioni

Konsumatori është në qendër të vëmendjes, që do të ketë trajtim dhe qasje të barabartë në shërbim, pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor. Duke përmbushur këtë mision do të bëhet i

mundur sigurimi i vetëqëndrueshmërisë me qëllimin e fundit që të sigurojë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Vizioni

Krijimi i shërbimeve sa më cilësore dhe të pandërprera të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbime të kanalizimit në regjionin e Mitrovicës, me çmime sa më të favorshme dhe me ujë cilësorë dhe të shëndetshëm për popullatën, si dhe rritjen e vlerës së aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.

Performanca Operative

Tabela 32: Performanca Vjetore Operative - KRU "Mitrovica" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Prodhimi i ujit në (000)m ³	23,175	22,578	25,199
Faturimi i ujit (%)	40	45	38
Inkasimi i ujit (%)	56	59	60
Uji i pafaturuar (%)	60	55	62
Testet e dështuara të ujit (%)	0	0,03	/
Konsumatorëve me ujëmatës (%)	65	84	64
Numri i konsumatorëve	29,066	26,618	27,407

Nga të dhënat e paraqitura më lartë, shihet se prodhimi i ujit në vitin 2016 ka pas një rritje prej 8% në krahasim me vitin paraprak si dhe 10.4% më të lartë se sa ai i planifikuar. Sa i përket pozicioneve Faturimi i ujit, Inkasimi i ujit dhe Uji i pafaturuar edhe pse caqet e projektuara në Plan të Biznesit kanë qenë në nivel mesatar prapë kanë shënuar variacione të konsiderueshme. Në veçanti:

- Shkalla e faturimi nga 45% sa ishte planifikuar ka pësuar rënje në 38%, kjo ishte zbritja më e madhe e shkallës së faturimit në vitet e fundit;
- Inkasimi i ujit ka pas një ngritje të lehtë në krahasim me Planin e Biznesit dhe vitin e kaluar;
- Uji i pafaturuar ka shkuar me një trend të rritjes në krahasim me planin dhe vitin paraprak.

Sa i përket Të Hyrave nga Shitja, Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” ShA në raportet financiare për të cilat Auditori i Jashtëm ka shprehur rezervë në dhënien e opinionit, ka regjistruar 3,578 mil. euro Të Hyra nga Shitjet apo për 5.2% më të larta se viti paraprak.

Performanca Financiare

Tabela 33: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Mitrovica" ShA

Treguesit Financiarë (‘000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	3,960	3,861	4,626 ⁹
Shpenzimet	(2,458)	(2,628)	(3,557)
Zhvlërimi dhe Amortizimi	(1,270)	(1,285)	(1,236)
Borxhet e këqija	0	(796)	0
APTIZHA	1,502	1,233	(1,069)
Të ardhurat (humbjet) neto	232	(848)	(167)
Paraja në fund vitit	120	130	232
Mjetet themelore	16,586	/	24,108

Sa i përket performancës financiare të KRU “Mitrovica” ShA secili pozicion ka shënuar variacione të vogla ndërmjet caqeve dhe realizimit. Siç mund të shihet edhe në Tabelë, variacionet financiare janë si në vijim:

- Të hyrat në fund të vitit kanë qenë për 16.5 % më të larta se plani;
- Shpenzimet në fund të vitit kanë qenë për 26.1% më të larta se sa plani;
- Zhvlerësimit dhe Amortizimit janë për 3.8% më të ulëta se sa plani.

Si rezultat i një performance të tillë operative dhe financiare, KRU “Mitrovica” ka përfunduar vitin 2016 me pozitën financiare si në vijim:

Tabela 34: Të ardhurat dhe pozita financiare - KRU "Mitrovica" ShA


Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	3,960	4,626	Pasuritë	35,121	43,609
Të hyrat e shitjes	3,393	3,578	Mjetet themelore	16,681	24,108
Të hyra tjera	567	974	Ekuiteti	27,505	27,336
vvShpenzimet	(3,728)	(4,793)	Detyrimet	7,616	16,273
Zhvlërimi	(1,270)	(1,236)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(1,396)	(1,310)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(1,062)	(1,679)	Kthimi në pasuri	0,66%	-0,38
Të dala tjera	-	-	Kthimi në ekuitet	0,84%	-0,61
APTIZHA	1,502	1,069	Kontributi nga aksionari ('000)	471	915
Të ardhurat neto	232	(167)	Subvencion	372	817
Nr. i punëtorëve	219	231	Projekte Kapitale	99	98

⁹ Subvencionet dhe grantet në vlerë prej: 816,849 euro janë futur në të hyrat totale për vitin 2016

Nga kjo Tabelë shihet se KUR “Mitrovica”, ka përfunduar vitin 2016 me rezultat financiar negativ. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KUR “Mitrovica” ka shënuar një rritje prej 22.2% dhe shpenzimet për paga një ulje prej 6,17% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e KUR “Mitrovica” gjatë vitit 2016 janë rritur për 19.5%, ekuiteti është zvogëluar për 0.6% dhe detyrimet janë rritur për 53.20% në krahasim me vitin 2015.

Grafikoni 10: Tendenca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU “Mitrovica” ShA



Të dhënat e korporatës			
Emri i Kompanisë:	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” ShA		
Nr. Biznesit	70433937	Nr.Fiskal	600294160
Kryeshefi Ekzekutiv:	Muhamed Suliqi		
Auditori i Jashtëm:	BDO Kosova LLC Prishtinë		

Përbërja e Bordit	Nga 30 Tetor 2015
Kryesues Bordi	Elhame Shefkui
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Ali Arifi
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Avdyl Hasani
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Xheladin Zenuni
Anëtar Bordi	Ariana Pireva
Anëtar Bordi	Xhemajl Aliu

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
22,735	3,240	0	0	25,975

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit “Hidromorava” ShA është Ndërmarrje Publike që ofron shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujërave të zeza në pjesën juglindore të Kosovës, përkatësisht në komunat e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës.

Prodhimi, shitja e ujit të pijshëm dhe mbledhja e ujërave të zeza janë aktivitetet kryesore të ndërmarrjes.

Vlerat kryesore të kompanisë janë përkushtimi për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj konsumatorëve, arritja e vetëqëndrueshmërisë financiare dhe të qenit transparent ndaj akterëve relevantë të sektorit të ujit në Kosovë.

Misioni

Furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe rrjetit të ujërave të ndotura me qëllim që të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, religjioz, kombëtar dhe gjinor.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët e regjionit të Gjilanit sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike, si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.

Performanca Operative

Tabela 35: Performanca Vjetore Operative - KRU "Hidromorava" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Prodhimi i ujit në (000)m ³	8,535	7,780	8,233
Faturimi i ujit (%)	39	48	43
Inkasimi i ujit (%)	78	77	82
Uji i pafaturuar (%)	61	52	57
Testet e dështuara të ujit (%)	/	/	/
Konsumatorëve me ujëmatës (%)	85	90	86
Numri i konsumatorëve	25,921	26,810	28,001

Të dhënat në Tabelën më lartë tregojnë se prodhimi i ujit në vitin 2016 është 5.5% më i lartë se sa plani dhe 3.5% më i ulët se në vitin 2015. Sa i përket pozicioneve Faturimi i ujit, Inkasimi i ujit, dhe Uji i pafaturuar, caqet e vendosura në kuadër të planifikimit në disa raste janë më të larta se realizimi, vërehen variacionet si në vijim:

- Faturimi i ujit nga 48% sa ishte planifikuar, është arritur të faturohet vetëm 43% që do të thotë se ka pas devijim nga Plani i Biznesit, por që ka qenë më i lartë se viti paraprak;
- Inkasimi i ujit ka arritur në kuotën 82%, në këtë rast përveq që janë tejkuluar parashikimet e Planit të Biznesit, ka pas tejkalim edhe në krahasim me vitin 2015;
- Uji i pafaturuar ka qenë më i lartë se plani dhe më i ultë se vitin e kaluar.

Kompania Ujësjellësi Rajonal "Hidromorava" ShA gjatë vitit 2016 ka realizuar Të Hyra nga Shitja në vlerën 2.027 mili. euro, apo 4% më shumë se vitin paraprak. Si rrjedhim, kjo kompani në vitin 2016 rezulton me një raport të të hyrave totale prej 3,263 euro apo për 32.6% më shumë se në vitin 2015. Kjo rritje ka ardhë si rezultat i drejtpërdrejt i rritjes së Të Hyrave të Shitjes.

Performanca Financiare

Tabela 36: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Hidromorava" ShA

Treguesit Financiarë (‘000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	2,199	1,622	3,263
Shpenzimet	(1,698)	(1,495)	(2,721)
Zhvlersimi dhe Amortizimi	(604)	(620)	(616)
Borxhet e këqija	/	/	/
APTIZHA	501	127	542
Të ardhurat (humbjet) neto	(103)	(493)	(74)
Paraja në fund të vitit	120	137	137
Mjetet themelore	9,501	8,800	9,096

Sa i përket performancës financiare të KRU “Hidromorava” ShA secili pozicion ka shënuar variacione të vogla ndërmjet caceve dhe realizimit. Siç mund të shihet edhe në Tabelë, variacionet financiare janë si në vijim:

- Të hyrat në fund të vitit kanë qenë për 50.3% më të larta se plani;
- Shpenzimet në fund të vitit kanë qenë për 45.2% më të larta se sa plani;
- Zhvlerësimit dhe Amortizimit janë për 0.6% më të ulëta se sa plani.

Si rezultat i një performance të tillë operative dhe financiare, KRU “Hidromorava” ka përfunduar vitin 2016 me pozitën financiare si në vijim:


Tabela 37: Të ardhurat dhe pozita financiare - KRU "Hidromorava" ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	2,199	3,263	Pasuritë	13,307	12,524
Të hyrat e shitjes	1,945	2,027	Mjetet themelore	9,501	9,096
Të hyra tjera	254	1,237	Ekuiteti	7,067	6,992
Shpenzimet	(2,302)	(3,337)	Detyrimet	6,240	5,532
Zhvlerësimi	(604)	(616)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(998)	(1,060)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(701)	(467)	Kthimi në pasuri	-0,78%	-0,59
Të dala tjera	-	-	Kthimi në ekuitet	-1,47%	-1,05
APTIZHA	501	542	Kontributi nga aksionari ('000)	197	
Të ardhurat neto	(103)	(74)	Subvencion	-	-
Nr. i punëtoreve	151	153	Projekte Kapitale	197	-

Nga kjo Tabelë shihet se KRU “Hidromorava”, ka përfunduar vitin 2016 me rezultat negativ, me një kthim në pasuri prej -0.6%. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KRU “Hidromorava” ka shënuar një rritje prej 31% ndërsa shpenzimet për paga janë rritur për 5.9% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e KUR “Hidromorava” gjatë vitit 2016 janë tkurrur për 5.9%, ekuiteti është zvogëluar për 1.1% dhe detyrimet janë zvogëluar për 11.4%.

Grafikoni 11: Tendenca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Hidromorava" ShA



Të dhënat e korporatës			
Emri i Kompanisë:	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" ShA		
Nr. Biznesit	70433918	Nr.Fiskal	600198867
Kryeshefi Ekzekutiv:	Agron Tigani		
Auditori i Jashtëm:	Universum Audit		

Përbërja e Bordit	Nga 24 Tetor 2015
Kryesues Bordi	Burim Basha
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Sokol Boqolli
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Muse Mushkolaj
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Skender Veseli
Anëtar Bordi	Esad Avdullahu
Anëtar Bordi	Sokol Boqolli

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
23,840	3,340	0	12,300	39,480

Veprimtaria e Ndërmarrjes

KRU "Hidrodrini" gjendet me seli në Pejë. Në strukturën e vet ka katër (4) njësi të biznesit në Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik. Përbëhet prej katër (4) departamenteve dhe katër (4) zyrave profesionale. Kompania është dhe do të mbetet ofrues profesional i furnizimit me ujë të pijshëm të kualitetit të lartë dhe të shërbimeve të kanalizimit. Prodhimi, shitja e ujit, shërbime e kanalizimit dhe shërbimet tjera janë detyrat kryesore të kompanisë.

Misioni

Të sigurojë ujë të pijshëm, të bollshëm dhe pa ndërprerje për të gjithë konsumatorët e saj pa dallim race dhe religjioni. Burimet e ujit duhet të shfrytëzohen racionalisht, për të siguruar furnizimin e pakufizuar dhe sipas standardeve të kërkuara.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës.

Performanca Operative

Tabela 38: Performanca Vjetore Operative - KRU "Hidrodrini" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Prodhimi i ujit në (000)m3	25,560	26,400	25,564
Faturimi i ujit (%)	34	36	35
Inkasimi i ujit (%)	73	70	78
Uji i pafaturuar (%)	66	64	65
Testet e dështuara të ujit (%)	0	1	0
Konsumatorëve me ujëmatës (%)	95	95	90
Numri i konsumatorëve	43,168	41,700	45,196

Të dhënat në Tabelën më lartë tregojnë se prodhimi i ujit në vitin 2016 ka pasur një ngritje prej 0.02% në krahasim me vitin 2015 dhe është për 3.2% më pak se sasia e planifikuar. Sa i përket pozicioneve Faturimi i ujit ka një ngritje prej 1% krahasuar me vitin 2015 por ka një rënie prej 1% krahasuar me Planin e Biznesit, Inkasimi i ujit po ashtu ka një ngritje prej 5% krahasuar me vitin paraprak 2015 por krahasuar me Planin e Biznesit ka një ngritje prej 8%, ndërsa Uji i pafaturuar ka një rënie prej 1%. Në veçanti:

- Faturimi i ujit është në nivelin po thuajse të njejtë me planin, ka një rënie prej 1%;
- Inkasimi i ujit është 8% më i lartë krahasuar me planin;
- Uji i pafaturuar është në nivelin më të lartë për 1% në krahasim me planin.

Performanca Financiare

Tabela 39: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Hidrodrini" ShA

Treguesit Financiarë (*000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	4,042	2,436	4,002
Shpenzimet	(2,234)	(2,280)	(2,299)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	(1,639)	/	(1,592)
Borxhet e këqija	(167)	/	(107)
APTIZHA	1,641	/	1,595
Të ardhurat (humbjet) neto	2	/	3
Paraja në fund të vitit	777	520	957
Mjetet themelore	22,526	/	21,058

Sa i përket performancës financiare të KRU "Hidrodrini" ShA në secilin pozicion janë shënuar variacione ndërmjet caqeve dhe realizimit. Siç mund të shihet në Tabelë variacionet janë si në vijim:

- Të hyrat në fund të vitit kanë qenë për 39% më të larta se plani dhe 1% më të larta se në vitin paraprak;
- Shpenzimet operative në fund të vitit kanë qenë për 1% më të larta se plani, dhe 2.8% më të larta se në vitin paraprak;


Si rezultat i një performance të tillë, KRU “Hidrodrini” ka përfunduar vitin 2015 me pozitën financiare si në vijim:

Tabela 40: Të ardhurat dhe pozita financiare - KRU "Hidrodrini" ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	4,042	4,002	Pasuritë	4,167	32,825
Të hyrat e shitjes	3,407	3,507	Mjetet themelore	2,955	21,058
Të hyra tjera	635	495	Ekuiteti	3,534	20,276
Shpenzimet	(4,040)	(3,999)	Detyrimet	633	12,549
Zhvlerësimi	(1,639)	(1,592)	Kreditë		-
Shpenzimet për paga	(1,393)	(1,463)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(841)	(107)	Kthimi në pasuri	0.08%	0.01%
Të dala tjera	(167)	(837)	Kthimi në ekuitet	0.10%	0.02%
APTIZHA	1,641	1,595	Kontributi nga aksionari ('000)	199	
Të ardhurat neto	2	3	Subvencion	-	-
Nr. i punëtorëve	216	214	Projekte Kapitale	199	-

Nga kjo Tabelë shihet se KRU “Hidrodrini”, ka përfunduar vitin 2016 me një rezultat minimal pozitiv, me një kthim në pasur prej 0.01%. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KRU “Hidrodrini” ka shënuar një rënie prej 1.1% dhe shpenzimet për paga kanë shënuar rritje prej 4.7% në krahasim me vitin paraprak.

Grafikoni 12: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Hidrodrini" ShA



Të dhënat e korporatës			
Emri i Kompanisë:	Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor”		
Nr. Biznesit	70433702	Nr.Fiskal	600349395
Kryeshefi Ekzekutiv:	Besim Baraliu		
Auditori i Jashtëm:	Audit & Konto		

Përbërja e Bordit	Nga 30 Tetor 2015
Kryesues Bordi	Rexhep Manxhuka
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Alban Zulfaj
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Ramadan Abazi
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Ylber Kuqi
Anëtar Bordi	Reshit Makica
Anëtar Bordi	Ridvan Hoxha

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
23,840	3,340	1,120	0	28,300

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Që nga korriku i vitit 2007 KRU “Hidroregjioni Jugor” funksionon si Shoqëri Aksionare. Kjo kompani shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës, duke përfshirë këto komuna:

- Prizren;
- Suharekë;
- Dragash;
- Malishevë.

Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve nëntokësore vetanake. Në nivel të kompanisë furnizohen edhe 39 fshatra që janë të kyçura në rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë.

Kapaciteti prodhues sillet deri në 900 l/sec. - Kapaciteti ndryshon varësisht nga kapacitetit i burimeve. Furnizimi bëhet 40% me pompa, 60% me gravitet. Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjellësit Regjional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

Misioni

Furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe rrjetit të ujërave të ndotura. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe qasje në shërbim: pa diskriminim racor, religjioz, kombëtarë, dhe gjinorë.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të shëndetësisë.

Performanca Operative

Tabela 41: Performanca Vjetore Operative - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi	Plani Biznesit	Realizimi
	2015	2016	2016
Prodhimi i ujit në (000)m3	17,309	17,760	17,370
Faturimi i ujit (%)	42	43	42
Inkasimi i ujit (%)	74	73	87
Uji i pafaturuar (%)	58	57	58
Testet e dështuara të ujit (%)	/	/	/
Konsumatorëve me ujëmatës (%)	95	/	94
Numri i konsumatorëve	42,753	43,611	44,633

Të dhënat më lartë tregojnë se prodhimi i ujit ka qenë 2.2% më i ulët sa sa plani, ndërsa në krahasim me vitin 2015, vëllimi i ujit të prodhuar është për 0.4% më shumë. Gjithashtu, variacionet e treguesve tjerë operativ janë si në vijim:

- Faturimi i ujit nga 43% sa ishte planifikuar, është faturuar vetëm 42% që do të thotë se ka pas devijim nga Plani i Biznesit për 1%, por që ka pas trend të njëjtë me vitin paraprak;
- Inkasimi i ujit është 87%, përqindja e lartë e inkasimit i ka tejkuluar parametrat e Planit të Biznesit dhe arritjet për vitin 2015.

KRU "Hidroregjioni Jugor" ShA gjatë vitit 2016 ka pasur Të Hyra nga Shitja 4,159 mil. euro apo 1.6% më shumë se në vitin paraprak. Si rrjedhim, kjo kompani në këtë periudhë raportuese rezulton me një raport të të hyrave totale prej 4,794 milion euro apo për 2.3% më shumë se në vitin 2015. Një rritje e tillë kryesisht i atribuohet rritjes të Të Hyrave nga Shitja.

Performanca Financiare

Tabela 42: Performanca Vjetore Financiare - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA

Treguesit Financiarë('000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	4,686	4,633	4,794
Shpenzimet	(3,373)	(3,118)	(3,746)
APTIZHA	1,061	1,515	1,048
Zhvlersimi dhe Amortizimi	(1,219)	/	(1,255)
Borxhet e këqija	(252)	/	(473)
Të ardhurat (humbjet) neto	(158)	/	(207)
Paraja në fund të vitit	2	/	109
Mjetet themelore	16,633	/	16,954

Performanca financiare për KRU "Hidroregjioni Jugor" ShA mund të matet vetëm për 3 pozicione, të hyrat, shpenzimet dhe të ardhurat para tatimit. Në këto pozicione vërehen variacionet si në vijim:

- Të hyrat e realizuara janë 3.4% më të larta se të planifikuara;
- Shpenzimet operative janë 16.8% më të larta se sa plani;
- APTIZHA ka shënuar një rënje për 30.8% në krahasim me Planin e Biznesit 2016.

Si rezultat i një performance të tillë, KUR "Hidroregjioni Jugor" ka përfunduar vitin 2016 me pozitën financiare si në vijim:


Tabela 43: Të ardhurat dhe pozita financiare - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	4,686	4,794	Pasuritë	19,750	20,673
Të hyrat e shitjes	4,092	4,159	Mjetet themelore	16,663	16,954
Të hyra tjera	594	635	Ekuiteti	8,473	8,266
Shpenzimet	(4,844)	(5,001)	Detyrimet	11,278	12,407
Zhvlerësimi	(1,219)	(1,255)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(1,763)	(1,861)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(1,862)	(1,865)	Kthimi në pasuri	-0,80%	-1,0
Të dala tjera	-	-	Kthimi në ekuitet	-1,86%	-2,50
APTIZHA	1,061	1,048	Kontributi nga aksionari ('000)	123	
Të ardhurat neto	(158)	(207)	Subvencion	25	-
Nr. i punëtoreve	305	319	Projekte Kapitale	98	-

Në këtë Tabelë shihet se KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA ka përfunduar vitin 2016 me një rezultat negativ, me një kthim në pasuri prej -1%. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA ka pasur një rritje prej 3.1% dhe shpenzimet për paga me një rritje prej 5.3% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA janë rritur për 4.5%, ekuiteti është zvogëluar për 2.5% dhe detyrimet janë rritur për 9.1%.

Grafikoni 13: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KUR "Hidroregjioni Jugor" ShA



Të dhënat e korporatës			
Emri i Kompanisë:		Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Radoniq” ShA	
Nr. Biznesit	70433554	Nr.Fiskal	600282636
Kryeshefi Ekzekutiv:		Ismet Ahmeti	
Auditori i Jashtëm:		Audit & Conto	

Përbërja e Bordit	Nga 24 Tetor 2015
Kryesues Bordi	Fatos Koshi
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Arbënesha Kuçi
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Xhevdet Morina
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Zeqir Fetoshi
Anëtar Bordi	Isuf Asllani
Anëtar Bordi	Shpat Mejzini
Anëtar Bordi	Qazim Qeska

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
24,750	3,240	0	0	27,990

Veprimtaria e Ndërmarrjes

Ndërmarrja KRU “Radoniq” ShA merret me prodhimin dhe distribuimin e ujit të pijshëm dhe për largimin e ujërave të zeza për regjionin Gjakovë, Rahovec dhe një pjesë të komunës së Prizrenit. Kështu, kjo kompani mbulon territorin me rreth 230.000 banorë, të cilët përfshihen në këto shërbime, me kapacitet 478 l/sec, apo prodhim të ujit të pijes në sasi prej 41.300 m³ në ditë.

KRU “Radoniq” ShA rrjetin e vet e shtrinë prej fshatit Skivjan deri në fshatin Zym, me rreth 230.000 banorë, që përfshin komunën e Gjakovës me 41 fshatra, dhe komunën e Rahovecit me 8 fshatra, si dhe 13 fshatra të komunës së Prizrenit. Kurse, aktivitetin për ujërat e zeza që janë inkuorporuar gjatë vitit 2006, zhvillohet në qytetin e Gjakovës dhe qytetin e Rahovecit. Furnizimi i liqenit bëhet nga lumi Lumbardhë i Deçanit, përmes kanalit derivues nga Lluka e Epërme deri të Lajthijat, pastaj nëpërmjet kanalit natyral-kanjonit derdhet në liqenin akumulues. Kapaciteti i liqenit është 117.000.000 m³. Kompania ka fabrikën për përpunimin e ujit në fshatin Zhdrellë, me kapacitet prodhues deri 600 litra për sekondë.

Qasja e afarizmit të kompanisë është transparente dhe etike, e bazuar në dispozita ligjore. Kjo bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Zyrën Rregullative për Ujë dhe Kanalizim, komunat, konsumatorët etj. Kompania, do të shikojë gjithashtu, që ujerat e zeza t’i përpunojë në të ardhmen nëpërmjet një impianti për trajtimin e ujërave të zeza.

Misioni

Furnizojë me ujë të pijshëm të gjithë konsumatorët e vet, pa dallim race, religjioni, apo kombësie në rajonin e tyre furnizues, për të siguruar një kompani financiarisht të vetëqëndrueshme dhe afatgjatë.

Vizioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, sipas normativave dhe standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe ta rrisë vlerën e aseteve publike si pronë e shtetit të Kosovës në rajon.

Performanca Operative

Tabela 44: Performanca Vjetore Operative - KRU "Radoniqi" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Prodhimi i ujit në (000)m3	13,722	14,527	15,248
Faturimi i ujit (%)	52	53	53
Inkasimi i ujit (%)	84	85	95
Uji i pafaturuar (%)	48	47	47
Testet e dështuara të ujit (%)	0	0	0
Konsumatorëve me ujëmatës (%)	95	97	98
Numri i konsumatorëve	32,937	34,962	34,353

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Radoniqi" ShA gjatë vitit 2016 ka pasur një rritje të prodhimit të ujit për 10% në krahasim me vitin 2015 dhe vëllimi i prodhuar është 4.7% më shumë se vëllimi i planifikuar. Sa i përket pozicioneve Faturimi i ujit, Uji i pafaturuar qëndrojnë të njëjta me planifikimin, ndërsa, Inkasimi i ujit shënon një rritje prej 10%, që do të thotë se ka shënuar variacione në mes të planifikimit dhe realizimit.

Performanca Financiare

Tabela 45: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Radoniqi" ShA

Treguesit Financiarë ('000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	4,111	4,170	4,201
Shpenzimet	(2,579)	(2,804)	(3,057)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	(1,735)	(1,606)	(1,676)
Borxhet e këqija	(167)	/	0
APTIZHA	1,532	2,972	1,144
Të ardhurat (humbjet) neto	(203)	(240)	(533)
Paraja në fund të vitit	361	522	943
Mjetet themelore	28,679	/	29,133

Sa i përket performancës financiare të KRU “Radoniqi” ShA në secilin pozicion janë shënuar variacione ndërmjet caqeve dhe realizimit. Siç mund të shihet në Tabelë variacionet janë si në vijim:

- Të hyrat në fund të vitit kanë qenë për 2.1% më të larta se vitin e kaluar, ndërsa krahasuar me planifikimin të hyrat kanë qenë më të larta për 0.7%.
- Shpenzimet operative në fund të vitit kanë qenë për 8.3% më të larta se plani, dhe po ashtu 15.6% më të larta se në vitin paraprak;
- Humbjet neto në fund të vitit kanë qenë 54,9% më të larta se plani dhe 61.9% më të ulëta se në vitin paraprak.


Si rezultat i një performance të tillë, KRU “Radoniqi”, në vitin 2016 ka rezultuar me një pozitë financiare si në vijim:

Tabela 46: Të ardhurat dhe pozita financiare - KRU "Radoniqi" ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	4,111	4,201	Pasuritë	38,480	37,379
Të hyrat e shitjes	3,752	3,791	Mjetet themelore	28,679	29,133
Të hyra tjera	359	410	Ekuiteti	34,000	31,601
Shpenzimet	(4,315)	(4,734)	Detyrimet	4,4480	5,778
Zhvlerësimi	(1,735)	(1,677)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(1,907)	(2,098)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(673)	(959)	Kthimi në pasuri	-0.53%	-1.43%
Të dala tjera		-	Kthimi në ekuitet	-0.60%	-1.69%
APTIZHA	1,532	1,144	Kontributi nga aksionari ('000)	550	1,494
Të ardhurat neto	(203)	(533)	Subvencion	-	-
Nr. i punëtorëve	254	255	Projekte Kapitale	550	1,494

Kjo Tabelë tregon se KRU “Radoniqi” ShA ka përfunduar vitin 2016 me një rezultat negativ financiar, me një kthim në pasuri prej -1.4%. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KRU “Radoniqi” ShA ka pasur një rënie prej 8.8% dhe shpenzimet për paga me një rritje prej 9.1% në krahasim me vitin paraprak.

Grafikoni 14: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Radoniqi" ShA



Të dhënat e korporatës			
Emri i Kompanisë:		Kompania Rajonale e Ujitjes “Drini i Bardhë” ShA	
Nr. Biznesit	70465032	Nr.Fiskal	600237524
Kryeshefi Ekzekutiv:		Milazim Shatri	
Auditori i Jashtëm:		Baker Tilly Kosovo	

Përbërja e Bordit	1 Dhjetor 2015
Kryesues Bordi	Beqë Hadërgjonaj
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Bekë Malushi
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Ali Gacaferri
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Naim Tahiri
Anëtar Bordi	Deme Qeta

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
20,760	3,240	0	0	24,000

Veprimtaria e Ndërmarrjes

KU “Drini i Bardhë” është Ndërmarrje Publike qendrore, ku aksionare e vetme e kësaj kompanie është Republika e Kosovës me 100% të aksioneve. Kjo kompani është e vendosur në Pejë dhe ka tri njësi punuese të vendosura:

- Njësia punuese – Pejë;
- Njësia punuese – Gurrakoc;
- Njësia punuese – Deçan.

KU “Drini i Bardhë”, ShA është përgjegjëse për ujitjen e tokave bujqësore në komunat e Pejës, Istogut, Deçanit dhe Junikut.

Misioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë, me qëllim të mundësisë së ujitjes së tokave, si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore me qëllim të shtimit të prodhimit të prodhimit të bujqësore, përmes kultivimit të kulturave intensive me produktivitet të lartë bujqësor.

Vizioni

Sigurimi i shërbimeve cilësore të ujitjes së kulturave bujqësore, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Kompanisë së “Drinit të Bardhë” – Pejë, si pasuri publike e shtetit të Kosovës.

Performanca Operative

Tabela 47: Performanca Vjetore Operative - KU "Drini i Bardhë" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi	Plani Biznesit	Realizimi
	2015	2016	2016
Uji i furnizuar (000 m3)	603	-	-
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	431	1,050	504
Faturimi (%)	100	100	100
Inkasimi (%)	22	54	49

Kompania Rajonale e Ujitjes “Drini i Bardhë” ShA ka shënuar një performancë negative operative ku vërehen variancione të konsiderueshme si më poshtë:

- Vëllimi i ujit të furnizuar është vlerësuar nga kompania, ngase, ujitja bëhet përmes kanaleve të dheut dhe nuk kanë ndonjë orëmatës me të cilin mund ta vërtetojnë se sa m³ shpenzojnë për ujitjen e numrit të hektarëve;
- Sipërfaqja e tokave bujqësore të ujitura është zvogëluar për 48% se sa planifikimi, dhe 14,50% është më e lartë se vitin paraprak;
- Faturimi është në nivelin 100% si në plan ashtu edhe në realizim;
- Inkasimi është 9% më i ulët se sa plani dhe 55% më i ulët se vitin paraprak.

Performanca Financiare

Tabela 48: Performanca Vjetore Financiare - KU "Drini i Bardhë" ShA

Treguesit Financiarë	Realizimi	Plani Biznesit	Realizimi 2016
(‘000€)	2015	2016	
Të hyrat	264	140	460
Shpenzimet	(121)	137	(217)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	(155)	/	128
Borxhet e këqija	0	/	/
APTIZHA	143		243
Të ardhurat (humbjet) neto	(12)	3	115
Paraja në fund vitit	1	/	130
Mjetet themelore	3,836	/	3,860

Kjo kompani gjatë periudhës 1 janar deri më 31 dhjetor 2016 ka shënuar variacione të konsiderueshme ndërmjet planit dhe realizimit. Në Tabelën lartë mund të shihet që KRU “Drini i Bardhë” ka variacionet si në vijim:

- Të hyrat janë 69.6% më të larta se plani;
- Shpenzimet operative janë 36.9% më të larta se plani.


Si rezultat i një performance të tillë, KRU “Drini i Bardhë”, në vitin 2016 ka rezultuar me një pozitë financiare si në vijim:

Tabela 49: Të ardhurat dhe pozita financiare - KRU "Drini i Bardhë" ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	264	460	Pasuritë	3,905	4,063
Të hyrat e shitjes	108	94	Mjetet themelore	3,836	3,860
Të hyra tjera	155	367	Ekuiteti	1,502	1,393
Shpenzimet	(276)	(345)	Detyrimet	2,404	2,670
Zhvlerësimi	(155)	(128)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(99)	(96)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(22)	(121)	Kthimi në pasuri	-0,33%	2.83%
Të dala tjera	-	-	Kthimi në ekuitet	-0,85%	8.26%
APTIZHA	143	243	Kontributi nga aksionari ('000)	323	390
Të ardhurat neto	(13)	115	Subvencion	15	240
Nr. i punëtorëve	44	33	Projekte Kapitale	308	150

Siç shihet në Tabelë, Kompania Rajonale e Ujitjes “Drini i Bardhë” ShA ka përfunduar vitin 2016 me një rezultat pozitiv financiar, me një kthim në pasuri prej 2.8%. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, KRU “Drini i Bardhë” ShA ka pasur një ngritje prej 20%, ndërsa, shpenzimet për paga një ulje prej 3% në krahasim me vitin paraprak.

Grafikoni 15: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Drini i Bardhë" ShA



Të dhënat e korporatës			
Emri i Kompanisë:	Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniqi – Dukagjin” ShA		
Nr. Biznesit	70465161	Nr.Fiskal	600287917
Kryeshefi Ekzekutiv:	Jahja Kadrija		
Auditori i Jashtëm:	Audit Check		

Përbërja e Bordit	Nga 30 Tetor 2015
Kryesues Bordi	Pal Gjuraj
Anëtar Bordi, Kryesues i KA	Muharrem Jupa
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Fahredin Krasniqi
Anëtar Bordi, Anëtar i KA	Fadil Kabashi
Anëtar Bordi	Ismet Neziri
Anëtar Bordi	Rrustem Thaqi

Kompensimet dhe Bonuset				
Bordi	Komisioni i Auditimit	Komisionet tjera	Bonuset	Gjithsej
12, 501	14, 461	0	0	26, 962

Veprimtaria e Korporatës

KU “Radoniqi – Dukagjini”, ShA- Gjakovë, është Ndërmarrje Publike qendrore, ku aksionar i vetëm i kësaj kompanie është Republika e Kosovës më 100% të aksioneve. Kjo kompani është e vendosur në Gjakovë dhe ka tri njësi punuese, të vendosura në fshatin Lugbunar (komuna e Gjakovës), në Xërxë (komuna e Rahovecit) dhe në Prizren.

Sistemi i ujitjes që posedon kjo kompani është i shtrirë në pjesën më pjellore të rrafshit të Dukagjinit. KRU “Radoniqi – Dukagjini” ShA është përgjegjëse për ujitjen e tokave bujqësore (si aktivitet primar), në komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe të Prizrenit.

Sasitë e planifikuara të ujit për sezonin e ujitjes varen nga sipërfaqet të cilat janë ujitur, llojin e kulturave, numrin e ujitjes, reshjeve, të cilat kanë dominuar gjatë sezonit vegjetativ.

Misioni

Të ofrojë shërbime të furnizimit me ujë, me qëllim të mundësisë së ujitjes së tokave si dhe shfrytëzimi i resurseve akumuluese ujore me qëllim të shtimit të prodhimtarisë bujqësore; përmes kultivimit të kulturave intensive me produktivitet të lartë bujqësor.

Vizioni

Sigurimi i shërbimeve cilësore të ujitjes së kulturave bujqësore, si dhe rritja e vlerës së aseteve publike të Kompanisë së Ujitjes “Radoniqi – Dukagjini”, si pasuri publike e shtetit të Kosovë.

Performanca Operative

Tabela 50: Performanca Vjetore Operative - KRU "Radoniqi-Dukagjin" ShA

Treguesit Operativë	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Uji i furnizuar (000 m3)	37,901	31,390	34,170
Ujitja e tokave bujqësore (ha)	5,121	4,992	5,128
Faturimi (%)	100	100	100
Inkasimi (%)	61	51	168

Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniqi-Dukagjin” ShA gjatë vitit 2016 ka shënuar një performancë të kënaqshme operative sa i përket ujit të furnizuar dhe faturimit, ku vërehen variacione të konsiderueshme si më poshtë:

- Vëllimi i ujit të furnizuar është 8.1% më i lartë se sa plani dhe 9.8% më i ulët se në vitin e kaluar;
- Sipërfaqja e tokave bujqësore të ujitura është 2.7% më e lartë se plani dhe 0.1% më e ulët se vitin paraprak;
- Faturimi është në nivelin 100% si në plan ashtu edhe në realizim;
- Inkasimi është 69.6% më i lartë se sa plani dhe 63.7 më i lartë se në vitin paraprak.

Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniqi – Dukagjin” ShA gjatë vitit 2016 ka pasur Të Hyra të Shitja 670 mijë euro apo 4.1% më shumë se në vitin paraprak.

Performanca Financiare

Tabela 51: Performanca Vjetore Financiare - KRU "Radoniqi - Dukagjin" ShA

Treguesit Financiarë ('000€)	Realizimi 2015	Plani Biznesit 2016	Realizimi 2016
Të hyrat	814	750	855
Shpenzimet	(440)	(515)	(484)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	(201)	(197)	(199)
Borxhet e këqija	(170)	(36)	(156)
APTIZHA	205	/	216
Të ardhurat (humbjet) neto	3	2	16
Paraja në fund të vitit	361	/	370
Mjetet themelore	2,955	/	2,758

Kjo kompani gjatë periudhës 1 janar deri më 31 dhjetor 2016 ka shënuar variacione ndërmjet plani dhe realizimit. Siç mund të shihet nga Tabela më lartë, KRU “Radoniqi – Dukagjini” ShA ka pasur variacione si në vijim:

- Të hyrat janë 12.3% më të larta se plani dhe 4.8% më të larta se viti paraprak;
- Shpenzimet operative janë 6% më të larta se plani dhe 9% më të larta se viti paraprak.

Si rezultat i një performance të tillë, KRU “Radoniqi-Dukagjin” ShA në vitin 2015 ka rezultuar me një pozitë financiare si në vijim:


Tabela 52: Të ardhurat dhe pozita financiare - KRU "Radoniqi-Dukagjin" ShA

Pasqyra e të ardhurave ('000)	2015	2016	Pozicioni financiar ('000)	2015	2016
Të hyrat	814	855	Pasuritë	4,167	4,132
Të hyrat e shitjes	699	670	Mjetet themelore	2,955	2,758
Të hyra tjera	116	186	Ekuiteti	3,534	3,550
Shpenzimet	(811)	(840)	Detyrimet	633	583
Zhvlerësimi	(201)	(199)	Kreditë	-	-
Shpenzimet për paga	(340)	(391)	Raportet Kyçe		
Shpenzimet tjera operative	(84)	(93)	Kthimi në pasuri	0,08%	0,38%
Të dala tjera	(185)	(156)	Kthimi në ekuitet	0,10%	0,44%
APTIZHA	205	216	Kontributi nga aksionari ('000)		
Të ardhurat neto	3	16	Subvencion	-	-
Nr. i punëtorëve	62	61	Projekte Kapitale	-	-

Nga Tabela mund të shihet se Kompania Rajonale e Ujitjes “Radoniqi-Dukagjin” ShA ka përfunduar vitin 2016 me një rezultat të lartë pozitiv financiar, me një kthim në pasuri prej 0.4%. Sa i përket shpenzimeve, KRU “Radoniqi-Dukagjin” ShA ka pasur një rritje prej 3.5% dhe shpenzimet për paga një rritje prej 13% në krahasim me vitin paraprak.

Si rrjedhim, pasuritë e KRU “Radoniqi-Dukagjin” ShA gjatë vitit 2016 janë tkurrur për 0.8%, ekuiteti është rritur për 0.5% dhe detyrimet janë zvogëluar për 7.8%.

Grafikoni 16: Tendanca e Pozicioneve Kyçe Financiare - KRU "Radoniqi-Dukagjin" ShA



Konkludime dhe Rekomandime

Nga të dhënat e pasqyruara në këtë Raport të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2016 dhe duke i krahasur me periudhën paraprake, mund të raportojmë një rënie të performancës së Ndërmarrjeve Publike qendrore me përjashtim të disa ndërmarrjeve.

Në bazë të treguesve kyç financiarë, performanca e ndërmarrjeve nuk është ajo që pritet, ku shumica e ndërmarrjeve kanë tendencë rënëse të kthimit në pasuri, tendencë të rritjes së lehtë të Të Hyrave nga Shitja që nuk është në harmoni me zhvillimin ekonomik, dhe tendencë rritëse të shpenzimeve për staf me përjashtim të disa ndërmarrjeve.

Si rrjedhim, duke pasur parasysh mangësitë e kornizës ligjore, si dhe mangësitë e sistemit të mbikëqyrjes së Ndërmarrjeve Publike në harmoni me praktikatat e mira ndërkombëtare, rekomandohet ndryshimi i ligjit, në harmoni me prioritetet strategjike të parapara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe duke u bazuar në parimet si në vijim:

- Bazë e mirë e qeverisjes korporatave për Ndërmarrjet Publike, duke përfshirë neutralitetin konkurrues në rastin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë produkte apo shërbime në tregje konkurruese;
- Vendosjen e kornizave për menaxhim në bazë të performancës, përmes futjes së qëllimeve dhe objektivave me caqet përkatëse të vendosura duke pasur parasysh resurset në dispozicion të cilat mund të përdoren për matjen e performancës së ndërmarrjeve;
- Vendosja e bazës së raportimit të mirëfilltë financiar dhe operativ të Ndërmarrjeve Publike në harmoni me praktikatat e zbatuara në BE për ndërmarrjet shtetërore dhe në linjë me parimet e OBEZH-së.

Prandaj në bazë të parimeve të lartpërmendura NJPMNP rekomandon masat në vijim që do të ndikojnë në përmirësimin dhe avancimin e performancës së NP-vë:

- Avancimi i mëtejshëm i Qeverisjes Korporative në përputhje me parimet e OBEZH-it përmes fuqizimit të strukturës mbikëqyrëse të ndërmarrjeve në pronësi publike.
- Përmirësimi i proceseve dhe sistemeve të menaxhimit financiar dhe vendosja e parimeve të menaxhimit sipas rezultateve.
- Përpos raporteve tjera vjetore financiare dhe jofinanciare, NP duhet të përfshijë planin mbi menaxhimin e rrezikut i cili do të përmbante në vete ciklin si identifikimi i rreziqeve, vlerësimi i efekteve të rreziqeve, interpretimi i rezultateve të vlerësimit të rrezikut, veprimet për zvogëlim të rrezikut dhe monitorimi i implementimit të sistemit të kontrollit të rrezikut.
- Politika e kompensimit për NP-të, përkatësisht për Bordin e Drejtorëve dhe atë menaxhues, si dhe stafin e brendshëm të NP-ve, duhet të jetë në diskrecion të plotë të aksionarit sipas objektivave. Kjo politikë duhet të jetë e harmonizuar sipas vlerës së NP-ve në treg, si dhe rëndësisë së ofrimit të shërbimeve/produkteve.

- Në kuadër të politikave të NP-ve, vlerësimi i gjëndjes së aseteve të Ndermarrjeve Publike të realizohet nga persona të licencuar dhe profesional me qëllim të vlerësimit real dhe të drejtë të gjëndjes së aseteve të Ndermarrjeve Publike.
- Rritja e kapaciteteve të njësisë me qëllim të fuqizimit të mbikëqyrjes, monitorimit dhe këshillimit të aksionarit për korporatat që i ka në pronësi.
- Fuqizimi i rolit të Komisionit të Ministrave mbi NP-të për vendimmarrje të fuqishme mbi mbrojtjen e interesave të Aksionarit.
- Themelimi i një Instituti të Qeverisjes Korporative, i cili do të bënte kualifikimin e personave që do të shërbenin më pastaj në bordet e emëruara, si dhe do të trajnonte bordet në detyrë.

Dokumentet Burimore

Raporti Vjetor i Performancës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovës në vitin 2016

<http://www.mzhe-ks.net/npmnp/?page=1,17> dokumentet si në vijim:

- Planet e Biznesit, Raportet Vjetore, Pasqyrat Financiare të Audituarra si dhe informata tjera për secilën ndërmarrje në pronësi të Qeverisë.
- Raportet e Zyrave Rregullative.